



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 220

Tiranë – E enjte, 17 dhjetor 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 139/2020, datë 26.11.2020	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane, për projektin Bashki të Forta..... 17149
Dekret i Presidentit nr. 11864, datë 9.12.2020	Për shpallje ligji..... 17160
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Brendshëm dhe i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nr. 463, datë 10.12.2020	Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin..... 17160
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 349, datë 14.12.2020	Për delegim kompetence..... 17175
Vendim i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 622, datë 10.12.2020	Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor..... 17176
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 201, datë 2.12.2020	Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë GSA sh.p.k., me nr. 321, seria T11/15, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike..... 17188
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 202, datë 2.12.2020	Mbi miratimin e “Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike, në tregun e parregulluar, për shoqërinë publike të furnizimit”..... 17189
	Vendim (i shkurtuar) për heqjen e zotësisë për të vepruar për shtetasen Florie Bani..... 17197



LIGJ
Nr. 139/2020

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
KONFEDERATËS ZVICERANE, PËR
PROJEKTIN BASHKI TË FORTA**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Konfederatës Zvicerane, për projektin Bashki të Forta, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 26.11.2020.

Shpallur me dekreten nr. 11864, datë 9.12.2020, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË KONFEDERATËS
ZVICERANE, PËR
PROJEKTIN BASHKI TË FORTA
FAZA PARAPRAKE: 1.7.2017–31.8.2018
FAZA 1: 1.9.2018–30.9.2022

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Brendshme, dhe Qeveria e Konfederatës Zvicerane, e përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe

Bashkëpunim (e referuar në këtë dokument si “SDC”), që vepron nëpërmjet Ambasadës së Zvicrës:

Në përpjekje për të forcuar marrëdhëniet miqësore që ekzistojnë ndërmjet dy vendeve;

Në përputhje dhe në zbatim të Marrëveshjes Kuadër, në lidhje me Bashkëpunimin Teknik, Financiar dhe Humanitar ndërmjet Këshillit Federal Zviceran dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të nënshkruar më 11 maj 2007;

Në respektim të parimeve demokratike dhe të të drejtave themelore të njeriut, siç parashtrohen veçanërisht në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, e cila frymëzon politikën e brendshme dhe të jashtme të të dyja Palëve dhe përbën një element thelbësor në pozita të barabarta me objektivat e Marrëveshjes aktuale,

Ministria e Brendshme dhe Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (nga këtu e më pas referuar si “SDC”) kanë rënë dakord mbi termat dhe kushtet, siç parashtrohen më poshtë.

Neni I

Kushtet e përgjithshme dhe përkufizimet

Termet e përdorur në këtë marrëveshje, vetëm nëse konteksti e kërkon ndryshe, kanë kuptimin e mëposhtëm:

a) “Palët Kontraktuese” janë Ministria e Brendshme e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Konfederata Zvicerane;

b) “Konfederata Zvicerane” përfaqësohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC);

c) “SDC” është Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Zvicrës, e cila përfaqësohet në Shqipëri nga Ambasada e Zvicrës;

d) Ministria e Brendshme e Republikës së Shqipërisë përfaqësohet nga ministri;

e) “Projekti” është projekti “Bashki të forta (*Strong Municipalities*) Shqipëri”;

f) “Organizatrat implementuese” janë *Helvetas Swiss Intercooperation (HSI)*, Instituti Shqiptar i Statistikave (INSTAT) dhe Zyra Federale Zvicerane e Statistikave (FSO).



Neni II

Përgjegjësia e implementimit

a) Ministria e Brendshme është agjencia homologe e Projektit.

b) SDC-ja është autoriteti ekzekutiv për zbatimin e Marrëveshjes dhe implementimin e Projektit. SDC-ja ia delegon përgjegjësinë e implementimit Ambasadës Zvicerane në Shqipëri.

c) SDC-ja i beson implementimin e Projektit *Helvetas Swiss Intercooperation*, INSTAT-it dhe Zyrës Federale të Statistikave.

Neni III

Qëllimet dhe objektivat

a) Qëllimi i përgjithshëm i këtij Projekti është: Njerëzit në Shqipëri të përfitojnë nga bashkitë me në qendër qytetarët dhe nga kryerja e shërbimeve të përmirësuara për menaxhimin e mbetjeve dhe arsimin parashkollor në nivelin bashkiak.

b) Objektivat kryesorë të Projektit janë:

1. Statistika zyrtare, të nivelit vendor: Pushteti Qendror dhe Vendor përdorin të dhënat zyrtare vendore dhe sistemin statistikor në nivelin vendor.

2. Administratë performuese, transparente: Administratat e bashkisë kryejnë funksionet e tyre për përmirësimin e kryerjes së shërbimeve të zgjedhura dhe nxitjes së përfshirjes së qytetarëve.

3. Këshilla të fortë bashkiakë: Këshillat bashkiakë forcojnë përfaqësimin e tyre dhe funksionet e mbikëqyrjes.

Për të përmbushur këta objektiva, Projekti bashkëpunon me institucionet e mëposhtme:

1. Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë;

2. 61 bashkitë në Shqipëri;

3. Të gjithë zyrat e prefekturave në Shqipëri;

4. Agjencitë dhe drejtoritë e decentralizuara;

5. Shkollën Shqiptare të Administratës Publike;

6. INSTAT-in, linjat kryesore të ndërhyrjes dhe rezultatet e parashikuara janë paraqitur shkurtimisht në përmbledhjen e Projektit në shtojcën 1.

Neni IV

Fusha e zbatimit të Marrëveshjes

Marrëveshja mbulon veprimtaritë e parashtruara në Përmbledhjen e Projektit, e cila i bashkëlidhet kësaj Marrëveshjeje.

Neni V

Përgjegjësitë e Ministrisë së Brendshme

Ministria e Brendshme:

a) Mbështet dhe ndërmjetëson lidhjen dhe bashkëpunimin me ministri dhe institucione të tjera, duke përfshirë institucionin e Prefektit të Qarkut;

b) Vë në dispozicion livrimin e buxhetit të nevojshëm për të rimbursuar Taksën mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) për Projektin për një shumë maksimale prej 1.1 milionë frangash zvicerane (një pikë një milionë franga zvicerane), për mandatin e implementuar nga *Helvetas Swiss Intercooperation* gjatë implementimit të projektit, që nga faza paraprake deri në fazën kryesore, përkatësisht 1 qershor 2017 deri më 31 gusht 2022. Vlera e TVSH-së, e cila përkon me 0.4 milionë franga zvicerane (zero pikë katër milionë franga zvicerane) për mandatin e implementuar në bashkëpunim me Zyrën Federale Zvicerane të Statistikave dhe INSTAT-in, vihet në dispozicion nga INSTAT-i në zbatim të marrëveshjes përkatëse.

c) U ofron ekspertëve të huaj të angazhuar në bazë të kësaj marrëveshjeje, si edhe familjeve të tyre përjashtimin nga të gjitha taksat gjatë periudhës së vlefshmërisë së Marrëveshjes aktuale, në bazë të nenit 4.1, pika “b”, të Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Konfederatës Zvicerane dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për Bashkëpunimin Teknik dhe Financiar dhe Ndihmën Humanitare.

Neni VI

Përgjegjësitë e SDC-së

a) Kontributi zviceran është një grant i parimbursueshëm dhe përdoret ekskluzivisht për implementimin e veprimtarive të Projektit, siç parashtrihen në shtojcën 1: Përmbledhja e Projektit, e cila përbën një pjesë të pandarë të kësaj Marrëveshjeje;



b) Granti për fazën 1 arrin deri në 12'800'000 franga zvicerane (dymbëdhjetë milionë e tetë qind mijë franga zvicerane);

c) Granti nuk mund të livrohet për asnjë qëllim tjetër. Çdo pjesë e papërdorur e grantit, e mbetur në fund të Projektit, i nënshtrohet kthimit mbrapsht ndaj SDC-së;

d) SDC-ja do të kontrakttojë *Helvetas Swiss Intercooperation*, INSTAT-in dhe Zyrën Federale Zvicerane të Statistikave si agjencitë implementuese;

e) Ky grant do të livrohet dhe auditohet në bazë të dispozitave të kontratës me *Helvetas Swiss Intercooperation*, INSTAT-in dhe Zyrën Federale Zvicerane të Statistikave.

Neni VII

Menaxhimi i Projektit

Projekti është një sipërmarrje e përbashkët ndërmjet Ministrisë së Brendshme dhe SDC-së përmes Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri.

Nga ana e Shqipërisë, Ministria e Brendshme:

- është bashkëpërgjegjëse për bashkëdrejtimin e takimeve të Komisionit Drejtues të Projektit;

- ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për të lehtësuar implementimin e veprimtarive të rëna dakord të Projektit;

- siguron kapacitetet për të asistuar partnerin implementues për pjesë të ndryshme të Projektit;

- siguron përdorimin e informacionit që disponon Ministria e Brendshme, duke përfshirë të dhëna statistikore, të cilat konsiderohen të domosdoshme dhe të dobishme për përmbushjen e objektivave të Projektit. Informacioni përdoret vetëm për qëllimet e Projektit. Çdo përdorim i informacionit jashtë qëllimit të Projektit, i nënshtrohet paraqitjes së kërkesës dhe marrjes së pëlqimit me shkrim nga Ministria e Brendshme.

Nga ana e Zvicrës, SDC-ja:

- është bashkëpërgjegjëse për bashkëdrejtimin e takimeve të Komisionit Drejtues të Projektit;

- është përgjegjëse për implementimin e përgjithshëm të Projektit;

- i ka besuar mandatin për implementimin e kësaj faze të Projektit (faza paraprake dhe faza I) *Helvetas Swiss Intercooperation*, në bazë të tenderit ndërkombëtar më 2017-ën dhe i ka dhënë Zyrës Federale Zvicerane të Statistikave dhe INSTAT-it mandatin për implementimin e komponentit të

Projektit të përgjithshëm Bashki të Forta “Forcimi i statistikave të nivelit vendor në Shqipëri (SALSTAT)”;

- mund t’u japë mandatin ekspertëve të huaj dhe vendës për periudha afatshkurtra dhe afatgjata për të mbështetur implementimin e Projektit;

- mund t’u japë mandatin individëve të tjerë dhe organizatave lokale dhe ndërkombëtare për implementimin e pjesëve specifike të Projektit.

Neni VIII

Mbikëqyrja dhe bashkërendimi

a) Në mënyrë që të sigurohet mbikëqyrja dhe bashkërendimi i Projektit, si edhe të trajtohen çështjet e politikës, do të krijohet një Komision Drejtues dhe takimet do të mbahen dy herë në vit.

b) Komisioni Drejtues përbëhet nga anëtarët e mëposhtëm me të drejtën e votës:

1. 1 përfaqësues nga Ministria e Brendshme (bashkëdrejtues);

2. 1 përfaqësues nga Ambada e Zvicrës (bashkëdrejtues);

3. 1 përfaqësues nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;

4. 1 përfaqësues nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;

5. 1 përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë;

6. 1 përfaqësues nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë;

7. 1 përfaqësues nga INSTAT-i

8. 1 nga FSO-JA;

9. 2 përfaqësues nga institucioni i Prefektit të Qarkut (në bazë rotacioni);

10. 9 përfaqësues nga njësitë e pushtetit vendor (në bazë rotacioni);

11. 1 përfaqësues nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike;

Anëtarët e mëposhtëm kanë statusin e vëzhguesve në Komisionin Drejtues, i cili do të vendoset në bazë të temës së diskutimit:

1. Përfaqësues nga njësitë e decentralizuara rajonale;

2. Përfaqësues nga institucionet përfituese;

3. Përfaqësues nga donatorë të tjerë të interesuar për këtë çështje.

Vëzhguesit nuk kanë të drejtën e votës.

Në bazë të nevojës dhe temës së diskutimit, aktorë të tjerë mund të ftohen për të marrë pjesë në



rolin e vëzhguesve nga bashkëdrejtuesit e Komisionit Drejtues.

Sekretariati i Komisionit Drejtues sigurohet nga ekipi i Projektit. Menaxhmenti i Projektit ndjek takimin pa të drejtën e votës.

c) Komisioni Drejtues kryen detyrat e mëposhtme:

1. Siguron që implementimi i Projektit të jetë në përputhje me qëllimet kryesore, objektivat dhe rezultatet e pritshëm të përcaktuar në dokumentin e Projektit;

2. Ofron këshillim për planet vjetore të Projektit për veprimtaritë, buxhetet dhe raportet vjetore;

3. Siguron që implementimi i Projektit të kontribuojë në dialogun e politikave për decentralizimin dhe qeverisjen vendore në vend;

4. Siguron dhënien dhe shkëmbimin e informacionit, në lidhje me zhvillimet përkatëse kombëtare, lidhjet dhe marrëdhëniet me aktorët e nivelit kombëtar.

5. Siguron që qëndrueshmëria e ndërhyrjeve të projektit të garantohet sa më shumë të jetë e mundur.

d) Takime të paplanifikuara mund të njoftohen në bazë të kërkesës së anëtarëve të Komisionit Drejtues. Takimet realizohen me praninë e bashkëdrejtuesve të Komisionit Drejtues.

e) Bordet këshilluese do të krijohen në mënyrë specifike për statistikën (rezultati 1) dhe për dy rezultatet e tjera, duke përfshirë grupet përkatëse të interesit.

Neni IX

Raportimi dhe Informacioni

Raportet e progresit përgatiten nga organizatat implementuese çdo 6 muaj.

Palët Kontraktuese informojnë menjëherë njëra-tjetrën dhe, deri në masën e arsyeshme praktike, konsultohen me njëra-tjetrën, në lidhje me ngjarjen, e cila ndërhyr apo kërcënon të ndërhyjë në implementimin e suksesshëm të Projektit.

Këto raporte të progresit të Projektit u vihen në dispozicion edhe ministrive të linjës, sipas fushave të tyre të përgjegjësisë.

Neni X

Monitorimi dhe vlerësimi

SDC-ja mbikëqyr implementimin e Projektit.

Mbi bazë të rezultateve të vlerësimit të jashtëm të Projektit që është planifikuar të kryhet më 2021, do të bazohet formulimi i fazës së ardhshme.

Neni XI

Prokurimi

Organizatat implementuese janë përgjegjëse për prokurimin e mallrave dhe të shërbimeve të nevojshme për implementimin e Projektit, duke zbatuar parimet e konkurrencës së ndershme (të lirë e të barabartë) ndërmjet ofertuesve të mundshëm, në mënyrë që të arrihet efikasiteti në përdorimin e fondeve publike.

Organizatat implementuese do të zbatojnë ligjin zviceran të prokurimit.

Neni XII

Mallrat

a) Për kohëzgjatjen e Projektit, mallrat e siguruar me fondet e SDC-së për përdorimin nga Projekti mbeten nën zotërimin e pakufizuar të Projektit dhe nuk dalin nga Projekti pa miratimin paraprak me shkrim të Ambasadës së Zvicrës në Shqipëri.

b) Nëse për ndonjë arsye Projekti ndërpritet, përdorimi i mallrave të siguruar përmes kontributit zviceran vendoset me shkrim nga Palët. Në një rast të tillë, SDC-ja nuk merr përsipër asnjë përgjegjësi në lidhje me mallrat në fjalë.

c) Në fund të Projektit, SDC-ja dhe organizatat implementuese të të dyja Palët bien dakord me shkrim për pronësinë dhe përdorimin e mallrave të prokuruar me fondet e Projektit.

d) Mallrat e prokuruar nga Projekti për organizatat implementuese, dorëzohen dhe merren në dorëzim nga autoriteti përkatës kompetent në bazë të miratimit nga SDC-ja.

Neni 13

Ndërprerja e Marrëveshjes

a) Secila Palë ka të drejtën të ndërpresë marrëveshjen aktuale, duke njoftuar me shkrim ndërprerjen, gjashtë muaj.

b) Nëse secila Palë pretendon se qëllimet e Marrëveshjes aktuale nuk mund të përmbushen më tej ose Pala e dytë nuk arrin të përmbushë detyrimet e saj, Pala tjetër ka të drejtën të pezullojë



apo të ndërpresë Marrëveshjen aktuale me anë të një njoftimi me shkrim tre muaj më parë. Pavarësisht nga sa thuhet më lart, secila Palë mund të ndërpresë Marrëveshjen aktuale me efekt të menjëhershëm, në rastin e një shkeljeje të rëndë të Marrëveshjes. Shkelje e rëndë është shkelja serioze e objektivave thelbësorë të Marrëveshjes aktuale.

c) Nëse ngjarjet, të cilat vijnë nga forcat madhore (fatkeqësitë natyrore etj.) pengojnë ekzekutimin e Marrëveshjes, secila Palë mund të ndërpresë Marrëveshjen, duke filluar në çastin kur ekzekutimi i saj është i pamundur.

d) Në rastin e ndërprerjes së parakohshme të Marrëveshjes aktuale ose në periudhën drejt fundit të Projektit, çdo fond i pashpenzuar, i siguruar brenda kuadrit të Projektit, i kthehet SDC-së.

Neni 14

Ndryshimet dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo modifikim apo ndryshim i Marrëveshjes aktuale kryhet me shkrim me pëlqimin e të dyja Palëve. Mosmarrëveshjet në lidhje me interpretimin apo zbatimin e dispozitave të Marrëveshjes aktuale zgjidhen me anë të negociimeve diplomatike ndërmjet Palëve.

Neni 15

Dispozitat e përgjithshme

Brenda kuadrit të kësaj marrëveshjeje, Palët nuk propozojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë përfitime të një natyre të çfarëdoshme. Ato nuk pranojnë propozime të tilla. Çdo sjellje korruptuese apo e paligjshme përbën shkelje të rëndë të marrëveshjes aktuale dhe justifikon ndërprerjen e saj si edhe/ose të drejtën për marrjen e masave korrigjuese shtesë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 16

Shtojcat

Përmbledhja e Projektit (shtojca 1) përbën një pjesë të pandarë të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 17

Kohëzgjatja dhe efikasiteti

Marrëveshja aktuale mbulon periudhën nga 1.7.2017 deri më 30.9.2022.

Ajo hyn në fuqi pas nënshkrimit nga të dyja Palët dhe përfundimit të procedurës së brendshme ligjore, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Marrëveshja aktuale është shkruar në dy kopje origjinale, në gjuhën angleze dhe në gjuhën shqipe. Në rast të ndryshimeve të interpretimit ka përparësi versionin në gjuhën angleze.

Palët, me anë të këtij dokumenti konfirmojnë dhe nënshkruajnë këtë Marrëveshje të lidhur në Tiranë, më 29.7.2020.

NË EMËR TË
KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Sandër Lleshaj
MINISTËR I
BRENDSHËM

NË EMËR TË
QEVERISË SË
KONFEDERATËS
ZVICERANE
Adrian Maitre
AMBASADOR
AMBASADA
ZVICERANE

SHTOJCA 1

E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT
TË MINISTRAVE TË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË ZVICRËS PËR PROJEKTIN
BASHKI TË FORTA (1.7.2017–30.9.2022)

1. Orientimi strategjik

1.1 Konteksti shqiptar dhe qeverisja vendore

Në vitin 2015, Reforma Territoriale Administrative (RTA) e zvogëloi numrin e bashkive nga 373 në 61. Me reformën e decentralizimit, ligje të reja u miratuan për funksionimin, organizimin dhe financimin e bashkive dhe funksione shtesë iu deleguan nivelit vendor. Objektivi i reformës ishte të përmirësonte kryerjen e shërbimeve për qytetarët, duke rritur efikasitetin dhe qeverisjen e mirë përmes decentralizimit fiskal. RTA-ja dhe reformat e decentralizimit krijojnë mundësi për zhvillimin vendor, në bazë të territoreve dhe të mundësive të shumta për rritjen e të ardhurave. 61 bashkitë janë pjesë e 12 qarqeve, në përbërje të të cilave ka dhe struktura të dekoncentruara: Agjencitë rajonale, si zgjatime të ministrive të linjës, janë të organizuara



sipas sektorëve (p.sh., mjedisi, arsimi etj.) dhe mbikëqyrin bashkitë në fushat e tyre të përgjegjësisë. Prefektura në secilin qark siguron përpunjen ligjore të politikave dhe të ligjeve kombëtare dhe monitoron zbatimin e standardeve kombëtare në nivelin vendor. Në vitet e ardhshme është njoftuar se do të kryhet një reformë në nivelin shtetëror rajonal, por ende nuk është përcaktuar fusha e saj e zbatimit. Bashkive të reja u është dashur të përballen me ristrukturime drastike dhe në të njëjtën kohë u është dashur të ofrojnë shërbime cilësore në terriore të zgjeruara. Të gjitha bashkitë kanë realizuar planet e zhvillimit vendor, të cilat kanë çuar në rritjen e kërkesës për statistika në nivelin vendor. Për më tepër, duke qenë se tashmë bashkitë janë më të mëdha, ato kanë nevojë për të dhëna, në mënyrë që të aplikojnë për financime vendëse dhe të huaja¹ të dhëna vendore të cilat praktikisht nuk ekzistojnë. Këshillat e rinj vendorë² u krijuan dhe përfaqësimi gjinor u përmirësua me 35% këshilltare femra. Votimi me lista të mbyllura të partive sjell linjat e llogaridhënies nga përfaqësuesit e zgjedhur kundrejt partive politike. Në përgjithësi, performanca e funksioneve bashkiake është e dobët dhe marrëdhëniet me qytetarët, si dhe me autoritetet bashkiake janë kryesisht jofunksionale. Aktualisht ka filluar forcimi i reformës. Rregulloret, udhëzimet dhe standardet e shërbimit në lidhje me ligjet e reja duhet të zbatohen. Paralelisht, kapacitetet efikase profesionale dhe menaxhuese dhe procedurat për administratën bashkiake duhet të përmirësohen. Mentaliteti dhe praktika e qeverisjes vendore për rritjen e të ardhurave, për përfshirjen kuptimplotë të qytetarëve dhe sektorit privat ka ende nevojë për përmirësim. Një sfidë tjetër është të kapërcehet ngërçi mes qytetarëve dhe administratës për nxitjen e qeverisjes së mirë në bazë të transparencës, përfshirjes së qytetarëve, llogaridhënies dhe të trajtohet mungesa e besimit ndërmjet qytetarëve dhe pushteteve vendore dhe këshillave vendorë.

1.2. Orientimi strategjik dhe përkatësia e asistencës zvicerane

Faza 1 e Bashki të Forta synon të forcojë qeverisjen bashkiake dhe funksionimin e këshillave vendorë, në bazë të vendimarrjes së informuar, në mënyrë që qytetarët të përfitojnë nga shërbimet e përmirësuara. Ajo është në përputhje me kuadrin gjithëpërfshirës strategjik të Shqipërisë i cili thekson përmirësimin e efikasitetit të strukturave të pushtetit vendor dhe sigurimit të shërbimit, forcimit të kapaciteteve fiskale, sigurimit të pushtetit të qëndrueshëm vendor dhe përforcimit të qeverisjes së mirë në nivelin vendor³. Për më tepër, ajo është në përputhje me ligjin për bashkëpunimin ndërkombëtar të Zvicrës, 2017–2020, i cili i vë theksin punës në nivelet e pushteteve vendore, të qarqeve dhe qendrore për të përforcuar strukturat demokratike, për të forcuar shtetin e së drejtës dhe për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve publike. Për më tepër, ndërhyrja e propozuar kontribuon në përmbushjen e objektivit demokratik në sektorin e qeverisjes: Njerëzit përfitojnë nga institucioni gjithëpërfshirës, efikas dhe demokratik i parashikuar në Strategjinë e Bashkëpunimit Zviceran Shqipëri, 2018–2021. Në shtator 2015, Shqipëria u bashkua me angazhimet globale, sipas Agjendës 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm, e cila mbështetet gjerësisht në veprimin e pushtetit vendor dhe thekson rëndësinë e statistikave të nivelit vendor. Qeveria e Zvicrës për vite me radhë ka mbështetur procesin e decentralizimit dhe forcimin e pushtetit vendor dhe ka kontribuar në mënyrë domethënëse ndaj RTA-së dhe decentralizimit. Si një bashkëdonatore kryesore në grupin e sektorit tematik të punës për decentralizimin, Zvicra luan një rol të rëndësishëm në bashkërendimin ndërmjet qeverisë dhe donatorëve, si edhe ndërmjet vetë donatorëve. Për rrjedhojë, ajo ka një përvojë të qëndrueshme dhe është një partnere e njohur në fushën e decentralizimit dhe qeverisjes vendore. Bashki të Forta është konceptuar si një ndërhyrje afatgjatë në forcimin e bashkive pas ristrukturimit të tyre, duke zgjeruar kështu mbështetjen zvicerane ndaj bashkive në mbarë vendin dhe duke forcuar reformën. SDC-ja do të kryejë një kontribut të

¹ Financimi kryesor vendës për buxhetin e zhvillimit është Fondi konkurrues i Zhvillimit Rajonal, fondet e huaja janë grantet e BE-së për vendin ndërkufitar (CBC).

² Këshillat vendorë janë organe legjislative bashkiake (parlamentet bashkiake).

³ Strategjia Kombëtare për Zhvillimin dhe Integrimin, Strategjia Kombëtare për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, Strategjia e Reformës për Administratën Publike, Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike, Programi i Statistikave Zyrtare për Shqipërinë, 2017–2021 dhe Strategjia e Menaxhimit të Mbetjeve.



dukshëm në fusha kryesore: ajo do të mbështesë sigurimin e shërbimeve strategjike për të treguar se sistemi i ri i sapopërcaktuar është në gjendje të kryejë dhe të sigurojë përfitime të prekshme për njerëzit. Kjo është një fushë ku Projekti mund të ndërtojë mbi përvojën e kaluar dhe të zhvillohet më tej dhe të arrijë në modelet e provuara. SDC-ja, gjithashtu, do të ndihmojë partnerët shqiptarë për krijimin e sistemit statistikor në nivelin vendor për nivelet nënkombëtare dhe sistemin e menaxhimit të orientuar drejt performancës për bashkitë. Të dyja elementet janë baza e kontrollit më të mirë dhe mbikëqyrjes, drejtimit dhe vendimmarrjes dhe do të jenë një kontribut thelbësor kundrejt rolit të këshilltarëve dhe përfshirjes së qytetarëve. Statistikat vendore përbëjnë një fushë e cila është tërësisht e patrajtuar nga iniciativa të tjera dhe ku Zvicra, në bazë të përvojave të kaluara mund të ndërtojë Projektin e decentralizimit dhe zhvillimit vendor (DLDP) dhe ku tashmë është krijuar një partneritet ndërmjet Institutit Shqiptar të Statistikave (INSTAT) dhe Zyrës Federale Zvicerane të Statistikave (FSO). Kjo, gjithashtu, do të ndihmojë Shqipërinë të përmbushë kërkesat e BE-së për vendet candidate dhe të mbështesë monitorimin e Agjendës 2030. Në të njëjtën kohë, Projekti do të mbështesë këshillat bashkiakë në rolin e tyre për të përfaqësuar interesat e qytetarëve dhe për të siguruar se burimet publike menaxhohen siç duhet. Kjo është një fushë së cilës i ka munguar mbështetja, por është thelbësore për sistemin e kontroleve dhe balancimeve. Në këtë drejtim, Bashki të Forta do të punojë me autoritetet dhe këshillat bashkiakë për të siguruar hapësirën për përfshirjen e qytetarëve dhe për të vepruar në mënyrë më transparente. Një tipar i veçantë i mbështetjes zvicerane është të krijojë marrëdhënie të besueshme ndërmjet aktorëve kryesorë vendës dhe të nxisë frymën e zgjidhjes së përbashkët të problemit.

Përfituesit e drejtpërdrejtë të programit janë 61 bashkitë – administratat e tyre (20'000 punonjës, 36% gra) dhe 61 këshilla (6152 këshilltarë, 35% gra). Përfituesi i tërthortë apo indirekt është niveli rajonal (prefektët, drejtoritë/agjencitë e shërbimeve, qarqet). Përfituesit e fundit janë 2.8 milionë qytetarët. Vizioni i Projektit deri në përmbylljen e tij (deri më 2024) është të bëjë që shërbimet dhe qeverisja të përmirësohen përmes përfitimeve të eficiencës dhe efikasitetit në sajë të

menaxhimit të përmirësuar dhe monitorimit të standardizuar të performancës, duke përfshirë vendimmarrjen në bazë e të dhënave, sipas statistikave të besueshme dhe përfshirjes më të fuqishme të qytetarëve dhe këshilltarëve, për shkak të transparencës së përmirësuar. Implementimi i Projektit është përcaktuar si një mbështetje ndaj strukturave qeveritare dhe do të bashkëpunojë ngushtë me ta me synim aftësimin e tyre në funksionet përkatëse. Faza e ardhshme është menduar t'u japë mbështetje të drejtpërdrejtë bashkive (p.sh., kombinimi i fondit). Projekti bashkëplotësues i SEOC-s për Menaxhimin e Financave Publike në nivel vendor, në këtë kontekst është thelbësor për uljen e rreziqeve fiskale, të cilat aktualisht pengojnë mbështetjen direkt në sistem.

1.3 Gjetjet kryesore nga faza paraprake

Gjatë fazës paraprake, u ngrit njësi i implementimit të Projektit dhe u kryen⁴ një sërë analizimesh për të përcaktuar fushat e ndërhyrjeve. Gjetjet e mëposhtme janë:

Statistikat dhe të dhënat e besueshme në nivelin vendor: të vetmet statistika zyrtare ekzistuese në nivelin vendor vijnë nga sondazhe të shtrenjta e të rralla (p.sh., regjistrimi i popullsisë/censi). Regjistrat e një popullsie, familjet, ndërtesat dhe adresat nuk ekzistojnë në Shqipëri. Megjithatë Zvicra ka kryer kalimin nga regjistrimi i popullsisë, me bazë sondazhi, në regjistrat e nivelit vendor në nivelin e bashkisë në dhjetëvjeçarët e fundit, Zyrës Federale Zvicerane të Statistikave (FSO) iu kërkua asistencë nga homologu i saj shqiptar. Gjetjet kryesore të fazës paraprake janë se të gjithë aktorët përkatës janë mjaft të motivuar për të bashkëpunuar për krijimin e këtyre regjistrave dhe do të trajnohen dhe përgatiten siç duhet për regjistrimin e popullsisë më 2030, i cili do të bazohet në regjistra.

Shërbimet bashkiake: Pavarësisht objektivit të caktuar nga Qeveria e Shqipërisë për përmirësimin e kryerjes së shërbimit, vlerësimet e ndryshme në bashki kanë treguar se sigurimi i shërbimit është i

⁴ Analizimet e përfshira: Nevojat për të dhëna në nivelin bashkiak, këshillat bashkiakë - përfaqësimi dhe funksionet e mbikëqyrjes, menaxhimi i bazuar në performancë për shërbimet e zgjedhura publike, oferta dhe kërkesa e statistikave rajonale dhe vendore në Shqipëri, shqyrtimi i literaturës së të dhënave dytësore për decentralizimin në Shqipëri.



dobët, duke i lënë qytetarët të pakënaqur dhe shpesh të painformuar për performancën, veçanërisht në zonat rurale, ku pakënaqësia është më e lartë duke qenë se akses i tyre ndaj shërbimeve është më i kufizuar. Pothuajse mungon një kulturë e menaxhimit në bazë të performancës, planifikimit të shërbimeve specifike dhe monitorimit dhe dhënies llogari ndaj përdoruesve dhe përfaqësuesve të tyre. Mbledhja e të dhënave dhe menaxhimi i tyre nga bashkitë është i dobët dhe pothuajse i kufizuar vetëm në sektorin e menaxhimit të ujërave dhe të mbetjeve. Pas marrjes parasysh të kriterëve të ndryshme, të tilla si avantazhi krahasues i Zvicrës në bashkëpunimin me Shqipërinë, funksionet e pushtetit vendor (ato të vjetrat, si p.sh., menaxhimi i mbetjeve dhe ato të sapodeleguarat, si p.sh., arsimi fillor), përfshirja sociale dhe aspektet gjinore – Projekti ka përzgjedhur dy shërbime të cilat do t'i mbështesë. Synimi është të përmirësohen shërbimet dhe menaxhimi bashkiak në përgjithësi, përmes paraqitjes së sistemit të menaxhimit të performancës (të bazuar në COFOG) dhe përmes proceseve të përcaktuara në dy sektorët e përzgjedhur. Funksionimi i këshillave vendorë: Këshillat luajnë një rol të skajshëm ndaj bashkive, shpesh nuk janë shumë në dijeni të detyrave të tyre dhe kanë akses të kufizuar ndaj informacionit përkatës. Komisionet e këshillave nuk janë funksionale dhe kapaciteti menaxhues i sekretariateve teknike të tyre është i ulët. Largimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë i përfaqësuesve nga zonat zgjedhore u rrit për shkak të RTA-së, veçanërisht në zonat rurale. Stimujt ndaj këshilltarëve janë ideuar sipas llogaridhënies ndaj partive politike më shumë se sa ndaj qytetarëve, për shkak të sistemit elektorale (lista të mbyllura partish), si edhe për shkak të interesave personalë. **Këshilltarët** gra janë më të prirura se sa meshkujt që t'u përgjigjen nevojave të komunitetit në bazë të sondazhit të Projektit. Bashki të Forta do të ndërtohet mbi instrumente të një Projekti të financuar nga USAID-i, i cili në të kaluarën ka punuar me këshillat vendorë.

Mobilizimi i qytetarëve: Qytetarët janë tërhequr në sferën private, apatia politike është mjaft e përhapur. Mekanizmat e konsultimit të krijuara me ligj janë vlerësuar se janë më se formale dhe zonat zgjedhore kanë lidhje të dobëta me këshilltarët. Administrata dhe këshillat nuk janë

gjithmonë në dijeni të detyrimeve të tyre ligjore, në lidhje me transparencën dhe përfshirjen e qytetarëve.

2. Vlerësimi i aktorëve

61 bashkitë janë në procesin e fuqizimit në territoret dhe funksionet e reja e të zgjeruara. 45/61 qeverisen nga kryetarët e bashkive, të cilët i përkasin së njëjtës parti politike, ndërsa 15 janë nga opozita aktuale. Motivimi për ushtrimin e roleve si kryetar bashkie është në përgjithësi i lartë. RTA-ja dhe decentralizimi i ka fuqizuar kryetarët e bashkive, ndërsa këshillat ende nuk po ushtrojnë funksionet e tyre. Këshillat bashkiakë deri tani nuk kanë marrë trajnime, por shihen si një potencial i lartë për performancën e përmirësuar. Ka interes dhe gatishmëri nga këshilltarët të cilët duan të marrin mbështetje për ushtrimin e detyrave të tyre. Bashkitë organizohen në shoqata përmes dy grupeve të ndara, sipas bindjeve partiake, duke dobësuar pushtetin e tyre për negociime. Nominimi i kandidatëve për kryetarë bashkie nga partitë politike tejet të centralizuara nuk ndihmon për të ndërprerë varësinë politike ndaj pushtetit qendror dhe partive. Administratës bashkiake i mungojnë shprehjet dhe pavarësisht përpjekjeve ende rekrutohet në bazë të bindjeve politike. **Agjencitë rajonale të dekoncentruara** kanë kapacitete të dobëta dhe aktualisht po kalojnë përmes procesit të ristrukturimit. **Prefekturat** përfaqësojnë pushtetin qendror dhe janë forcuar paralelisht me procesin e decentralizimit në vitet e fundit. Projekti planifikon të punojë me këto institucione rajonale për t'u mundësuar atyre të ndajnë ushtrimin e funksioneve të tyre dhe të forcojnë sistemin. Përfshirja e sektorit privat në shërbimet publike do të nxitet përmes partneritetit me administratën vendore dhe do të ndërtohet në bazë të përvojës së DLDP-së. Në të njëjtë kohë po kryhet një hartëzim i detajuar i rolit dhe pjesëmarrjes së sektorit privat në menaxhimin e mbetjeve, gjë që do të shërbejë dhe si *baseline* për Projektin. **Pushteti qendror** ka promovuar agjendën për reformën në qeverisje përmes vullnetit politik për të forcuar agjendën e decentralizuar. Interesi i saj është të sigurohet që bashkitë do të përmbushin funksionet e tyre, sepse decentralizimi i mëtejshëm nuk pritet për këtë mandat të qeverisë aktuale. Institucionet e pushtetit qendror, të tilla si: INSTAT-i dhe Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, do të jenë partnerët kryesorë të implementimit të Projektit. **Partnerët e**



zhvillimit: Iniciativa të reja filluan në mënyrë bashkëplotësuese, në fusha të tilla si: menaxhimi i financave publike në nivel vendor (SECO), taksat mbi pronën dhe politikat për komunitetin (SIDA), zhvillimi ekonomik vendor dhe mbledhja e të ardhurave (USAID), përgatitja për në BE dhe financimi (EUD), shërbimet sociale (UN), shërbimet/arkivat administrative (STAR 2). SDC-ja do të marrë përsipër sigurimin e bashkërendimit të donatorëve në nivelet strategjike, ndërsa Projekti do të bashkërendojë në baza të rregullta të gjithë partnerët e tjerë.

3. Objektivat

Qëllimi i përgjithshëm: Njerëzit në Shqipëri përfitojnë nga bashkitë me në qendër qytetarët dhe kryerjen e shërbimeve të përmirësuara për mbetjet dhe arsimin parashkollor në nivelin bashkiak.

Rezultati 1 – Statistika zyrtare, të nivelit vendor: Pushteti qendror dhe vendor përdorin të dhëna zyrtare vendore dhe sistemin statistikor të nivelit vendor.

Rezultati 2 – Administratë performuese, transparente: Administrata bashkiake që kryejnë funksionet e tyre për përmirësimin e kryerjes së shërbimeve të zgjedhura dhe nxitjen e përfshirjes së qytetarëve.

Rezultati 3 – Këshilla të fortë bashkiakë: Këshillat bashkiakë forcojnë përfaqësimin e tyre dhe funksionet e mbikëqyrjes.

Hipotezat e ndikimit: Duke forcuar kapacitetet e pushteteve vendore dhe përfaqësuesit e zgjedhur në këshillat vendore, veçanërisht gratë, dhe përmes sigurimit të të dhënave dhe statistikave të qëndrueshme nga niveli vendor të kombinuara me më shumë transparencë dhe përfshirje të qytetarëve, pushteti vendor do t'i nënshtrohet llogaridhënies për performancën e vet. Ndaj, sipërmarrja për të kryer shërbime cilësore dhe të barabarta për të gjithë qytetarët në qendër dhe në periferi do të rritet me rritjen e transparencës dhe të matjes së performancës. Kjo do të çojë në një qëndrueshmëri të bashkive të sapokrijuara për të përmirësuar mirëqenien e qytetarëve shqiptarë.

4. Strategjia e ndërhyrjes

Bashki të forta do të punojë me të 61 bashkitë në Shqipëri, megjithatë strategjitë e ndërhyrjes ndryshojnë ndërmjet rezultateve: **Rezultati 1:** Mbështetja për të ndërtuar një sistem statistikor vendor në bazë të regjistrat (duke krijuar regjistrat

e popullsisë, familjeve, adresave dhe pronave dhe duke përcaktuar treguesit statistikorë kryesorë të të gjithë bashkive dhe qarqeve) do të jetë një kontribut kryesor ndaj qeverisë shqiptare dhe përfshin si implementues INSTAT-in, të gjitha bashkitë dhe aktorët qendrorë (p.sh., regjistrin civil). Krijimi i kapaciteteve dhe mbështetja e strukturës organizative të INSTAT-it dhe zyrave rajonale/vendore do të jenë kryesore për përmirësimin e qeverisjes së sistemit. FSO-ja është përgjegjëse për këtë linjë ndërhyrjeje. INSTAT-i është implementuesi kryesor dhe e gjithë ndërhyrja është tërësisht në sistem.

Rezultati 2: Projekti do të funksionojë me përmirësimin e të dy shërbimeve (menaxhimin e mbetjeve dhe arsimin parashkollor), të cilat janë funksionet kryesore të bashkive. Katër zona për trajtimin e mbetjeve⁵ do të përcaktohen dhe deri në 30 bashki do të mbështeten drejtpërdrejt për përmirësimin e menaxhimit të qëndrueshëm të mbetjeve në nivelin bashkiak. Zhvillimi i partneritetit publik privat, mbështet sondazhet e nevojshme për rregulloren dhe funksionimin e zonave të trajtimit të mbetjeve, si zona të rëndësishme, përveç trajnimit në punë të bashkive, në bashkëpunim me strukturat rajonale përgjegjëse për trajtimin e mbetjeve. Për shërbimin e arsimit parashkollor do të zhvillohet një model për menaxhimin në nivelin bashkiak⁶, në bazë të bashkive, të cilat përfaqësojnë 6 tipologji (urbane dhe rurale në veri, qendër, jug) të përcaktuara në fazën paraprake së bashku me ministritë e linjës. Zgjerimi i këtij shërbimi për mbulimin e plotë të vendit është parashikuar në fazën 2. Sipas të njëjtut rezultat Projekti do të punojë me të gjitha 61 bashkitë për matjen e performancës së shërbimeve bashkiake (lidhje me COFOG/buxhetin e programit) dhe siguron mbështetje të trajnimit në punë ndaj aktorëve bashkiakë në bashkëpunim me zyrat e prefekteve

⁵ Nga nëntë, ku pesë të tjerat mbulohen nga partner të tjerë të zhvillimit dhe sigurohet bashkërendimi ndërmjet ndërhyrjeve.

⁶ Krijimi i mjeteve model për të krijuar një plan afatmesëm për bashkinë në këtë sektor duke përfshirë përcaktimin e burimeve të nevojshme, afatet kohore, standardet, skemat e financimit dhe mekanizmat e llogaridhënies. PDZHV ka përcaktuar një model të tillë në sektorin e mbetjeve të ngurta-në sektorin e arsimit parashkollor kjo nuk ekziston dhe rezultati është se nuk po ndodh asnjë planifikim strategjik.



të cilat janë përgjegjëse për monitorimin. Ky sistem i ri do të lejojë për herë të parë bashkitë, nivelin rajonal dhe qendror të krahasojnë bashkitë e ndryshme të bazuara në një metodologji të standardizuar dhe do të jetë një mjet i rëndësishëm për qytetarët (zgjedhjet, pjesëmarrja), këshillat (mbikëqyrja) dhe kryetarët e bashkive (drejtimi, konteksti i prioritetëve) si edhe për nivelet e qarqeve (prefektët) dhe qendrore; Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë për një performancë të ardhshme të bazuar në sistemin e financimit, për Ministrinë e Brendshme dhe ministrinë e tjera të linjës, për të monitoruar kryerjen e shërbimeve. Duke pasur në zbatim një mekanizëm për rritjen e performancës së administratës, e cila mund ta përdorë atë dhe qytetarët mund të kërkojnë llogaridhënie përmes përfshirjes në këtë mekanizëm, masat për nxitjen e ndryshimit të sjelljes së autoriteteve të bashkisë janë parashikuar të merren. Projekti fillimisht do të nisë në ato bashki ku SECO do të punojë në raundin e parë për Menaxhimin e Financave Publike lokale për të garantuar bashkërendimin dhe sinergjitë e mira. Sipas **Rezultatit 3** trajnimi dhe përgatitja e këshilltarëve dhe e sekretarive për ushtrimin e funksioneve të tyre do të përqendrohet në të gjithë 61 këshillat bashkiakë. Krijimi i procedurave të brendshme dhe menaxhimi do të përcaktohen përveç krijimit të kapaciteteve. Parimet e qeverisjes së mirë do të hartohen. Përpara zgjedhjeve elektorale në mes të vitit 2019, Projekti do të modelojë mbështetjen dhe do të jetë i gatshëm për të filluar punën me përfaqësuesit e zgjedhur menjëherë pas konfirmimit të mandateve të tyre. Grupet e aleancave të grave (të përbëra nga këshilltare gra përgjatë linjave partiake) do të arrihen me anë të trajnimeve dhe veprimeve specifike. Studimet bazë për kuadrin logjik do të përfundohen brenda gushtit të vitit 2018. Komponenti i parë i Projektit, rezultati 1, i cili mbështet krijimin e një sistemi të statistikave vendore në Shqipëri (SALSTAT) implementohet në partneritet me Zyren Federale Zvicerane të Statistikave (FSO) dhe Institutin Shqiptar të Statistikave (INSTAT). Mandati për rezultatin 2 dhe 3 i jepet *Helvetas Swiss Intercooperation (HSI)*, në bazë të një tenderi ndërkombëtar për këto komponentë. Faza 1 e Bashki të Forta është bashkëplotësuese e

iniciativave të tjera të financuara nga Zvicra me synim forcimin e menaxhimit të financimit publik të nivelit nënkombëtar (SECO), menaxhimin e mbetjeve të ngurta (SECO), shërbimet sociale (*Leave no one behind*), shëndetësia dhe demokracia vendore (projekti Lëviz Albania).

Puna e drejtpërdrejtë në sistem: Përvoja ka provuar se vetëm trajnimi nuk është i mjaftueshëm për të ndryshuar praktikën në bashki. Trajnimi në punë, për rrjedhojë është i domosdoshëm, përveç shkëmbimit të ideve me kolegët, kurrikulave zyrtare dhe udhëzimeve. Projekti do të përfshijë sa më shumë të jetë e mundur nivelin e qarkut, siç përshkruhet në kreun 2, përmes 12 koordinatorëve rajonalë (të terrenit). Synimi është që këta koordinatorë të punojnë me autoritetet përkatëse rajonale dhe t'i përfshijnë ato fuqimisht në trajnimet e tyre në punën në bashki. Duke pasur kontekstin e reformës fluide dhe reformat e pritshme të nivelit rajonal, zbatohet një qasje e përshtatshme e menaxhimit të programit. **Temat transversale:** barazia gjinore dhe përfshirja sociale janë pjesë e pandarë e ndërhyrjes dhe pasqyrohen në kuadrin logjik. Zgjedhja e shërbimeve (mbetjet dhe parashkollori) u bë në bazë të përfshirjes sociale dhe kriterit të bazuar në gjini dhe puna në këshilla do të përfshijë theksimin e vazhdueshëm të çështjeve të ndjeshme gjinore (me të gjithë aleancat e grave këshilltare).

5. Burimet

Buxheti total për fazën 1 arrin deri në **12.8 milionë franga zvicerane**. Kostot e rezultatit 1 ndahen ndërmjet kostove të FSO-së, të cilat numërohen si kostot e administratës së vet federale dhe ato suplementare ndaj kësaj kredie dhe kostot e Projektit prej 3.2 milionë frangash zvicerane. Pjesa e implementuar nga *Helvetas Swiss Intercooperation* arrin deri në 8,75 milionë franga zvicerane, nga të cilat 60% u kushtohet fondeve të administruara pjesërisht, pjesa e mbetur do të përdoret për asistencë teknike dhe për ekipin e Projektit. Grantet e vogla (0.68 milionë franga zvicerane për 4 vjet për 61 bashki) janë parashikuar si parafillestare për bashkitë në bazë të performancës dhe përgatitjes terrenin për një skemë granti të bazuar në performancë. Transferimi në sistem do të zbatohet. Investimi për frymë është rreth 4.50 4. franga zvicerane.



Monitorimi i performancës nga bashkitë për funksione të rëndësishme, të tilla si menaxhimi i mbetjeve dhe arsimit parashkollor janë elementet kyçe për efikasitetin e rritur në përdorimin e burimeve publike për të përmbushur detyrimet publike dhe për përfitime më të shumta, të cilat shkojnë në dobi të qytetarëve. Prania e shumë këshillave përfaqësues do të forcojë kuptimin e llogaridhënies së administratave bashkiake ndaj qytetarëve, duke ulur korrupsionin dhe abuzimin

me pushtetin. Përmirësimi cilësor, përfitimet e efikasitetit dhe të eficiencës përmes vendimmarrjes së bazuar në fakte falë të dhëna të besueshme (SALSTAT) pritet të ndodhin. SDC-ja do të autorizojë vlerësim të jashtëm nga mesi ose fundi i fazës ku do të përfshihet edhe vlerësim për eficiencën financiare. Partnerët në nivelin qendror janë planifikuar që të ofrojnë hapësirë për punë për koordinatorët rajonalë, si një mënyrë për të lehtësuar bashkëpunimin.

PA	Përshkrimi	Faza paraprake (Kredia e hapjes)	Faza e Implementimit I (Kredia Kryesore)					Faza e Kredisë Totale 1
		2017-2018	2018	2019	2020	2021	2022	
p.m.	Kostot e FSO për projektin	230'000	108'000	216'000	216'000	216'000	108'000	1'094'000
01	Mandati për kostot e projektit HSI	400'000						400'000
11	Mandati për kostot e projektit HSI, O2, O3		1'000'000	2'600'000	2'500'000	2'150'000	500'000	8'750'000
02	Kostot e Projektit SALSTAT/FSO	400'000						400'000
12	Kostot e Projektit SALSTAT/FSO, O1		600'000	800'000	800'000	800'000	200'000	3'200'000
13	Vlerësimi i jashtëm					50'000		50'000
	TOTALI	800'000	1'600'000	3'400'000	3'300'000	3'000'000	700'000	12'800'000

Monitorimi dhe drejtimi

Projekti miraton sistemin e raportimit të bazuar në rezultate, duke u përqendruar në monitorimin e rezultateve, në lidhje me kuadrin logjik, planet e punës dhe buxhetin përkatës. Raportet do të miratohen nga komisioni drejtues, i cili do të krijohet nga përfaqësues të nivelit të lartë nga SDC-ja, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Arsimit, njësitë e pushtetit vendor, INSTAT-i

dhe strukturat e pavarura rajonale. SDC-ja do të bashkëdrejtojë komisionin drejtues. Partnerë të tjerë të zhvillimit do të ftohen si anëtarë vëzhgues. Bordet këshilluese do të krijohen posaçërisht për statistikën dhe të dyja rezultatet e tjera, duke përfshirë aktorët përkatës. Bashkërendimi ndërmjet implementuesve kryesorë (FSO/INSTAT dhe HSI) ndërmjetësohet nga ambasada në bazë të përvojës pozitive të deritanishme.

**DEKRET****Nr. 11864, datë 9.12.2020****PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës;

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 139/2020, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane, për projektin bashki të forta”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

UDHËZIM I PËRBASHKËT**Nr. 463, datë 10.12.2020**

**PËR PËRCAKTIMIN E
INSTITUCIONEVE DHE ORGANEVE
QË MARRIN TË DHËNA PERSONALE
NGA SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE, SI
DHE MËNYRËN, LLOJIN DHE SASINË
E INFORMACIONIT QË DUHET
TË MARRIN**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; pikave 2, 2/1 dhe 3, të nenit 3, të pikës 2 të nenit 60, të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, si dhe shkronjës “k” të pikës 1 të nenit 31 dhe nenit 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, ministri i Brendshëm dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

UDHËZOJNË:

1. Institucionet, organet, personat juridikë publikë (kontrolluesit publikë) mund të marrin të dhëna personale nga të dhëna të administruara nga shërbimi i gjendjes civile, Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile (RKGJC) i vitit 2010, nga regjistrat themeltarë të regjistrimit të popullsisë dhe nga aktet

e gjendjes civile, nëse kjo e drejtë u njihet me ligj të veçantë. Mënyra, lloji dhe sasia e informacionit që mund të marrin përcaktohet në aneksin I, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

2. Informacioni, sipas aneksit I, përcillet në rrugë elektronike dhe/ose shkresore, siç parashikohet rast pas rasti në këtë aneks.

3. Personat juridikë apo fizikë privatë (kontrolluesit privatë), mund të marrin të dhëna personale nga Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile, nga regjistrat themeltarë dhe nga aktet e gjendjes civile të një personi, vetëm nëse marrin pëlqimin me shkrim nga ana e subjektit të të dhënave. Përfundim nga kjo rregull, bëjnë vetëm rastet kur një përpunim i tillë i të dhënave personale nga kontrolluesit privatë, autorizohet nga dispozitat e legjislacionit në fuqi.

4. Për marrjen e informacionit në rrugë elektronike, kriteret dhe kushtet konkrete përcaktohen në marrëveshje dypalëshe midis Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe kontrolluesit përkatës dhe/ose sipas parashikimeve të tjera të legjislacionit në fuqi.

Në çdo rast, marrëveshjet në fjalë rregullohen në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, si dhe me aktet nënligjore të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

5. Për marrjen e informacionit në formë shkresore, kontrolluesit i drejtohen me kërkesë të motivuar Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile ose zyrës përkatëse të gjendjes civile, sipas organizimit të shërbimit të gjendjes civile në bashki/njësi administrative, ose zyrës së arkivit të gjendjes civile pranë prefektit të qarkut që administrojnë dokumentacionin, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

6. Kërkesat drejtuar shërbimit të gjendjes civile, sipas pikave 4 dhe 5 të këtij udhëzimi, duhet të shoqërohen me formularin sipas aneksit III, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi, në të cilin subjekti i të dhënave personale ka shprehur pëlqimin e tij.

7. Përfundim nga rregulla e përcaktuar në pikën 6 kontrolluesit, të cilët autorizohen me ligj për të përpunuar të dhënat personale të subjekteve të të dhënave personale për qëllime të veprimtarisë së tyre.

8. Kontrolluesit që kërkojnë të dhëna personale duhet të shprehin qartë bazën ligjore, mbi të cilën



mbështesin kërkesën e tyre, qëllimin për të cilin do të përdoren këto të dhëna, si dhe llojin e të dhënave që kërkojnë. Të dhënat personale jepen vetëm në rastet kur ato nevojiten për përmbushjen e një detyrimi të parashikuar ligjor.

9. Kërkesa për marrjen e të dhënave personale bëhet duke plotësuar formularin “Kërkesë për marrjen e të dhënave personale”, sipas aneksit II, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

10. Kontrolluesit, që marrin të dhëna personave, në asnjë rast nuk duhet t’i përhapin ato te palë të treta, pavarësisht faktit se këto të fundit mund të jenë të legjitimuara për t’i përpunuar këto të dhëna. Përfshirë nga kjo rregull bëjnë vetëm rastet e parashikuara me ligj.

11. Punonjësit e zyrave të gjendjes civile në bashki/njësi administrative dhe në zyrat e arkivit të gjendjes civile pranë prefektit të qarkut regjistrojnë të gjitha kërkesat, duke evidentuar datën kur është paraqitur kërkesa, kontrolluesin që kërkon të dhëna personale, të dhënat që kërkohen të përpunohen dhe ato të cilat janë dhënë ose jo, si dhe qëllimin e deklaruar nga kontrolluesit në fjalë për përpunimin e këtyre të dhënave. Këto informacione i jepen, sipas kërkesës, Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili mund t’i përdorë për qëllime hetimi administrativ dhe/ose për qëllime statistikore.

12. Ministri i Brendshëm dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, përditësojnë aneksin I, në mënyrë periodike dhe/ose brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës së një kontrolluesi të caktuar për t’u përfshirë në këtë aneks.

13. Ngarkohen me zbatimin e këtij udhëzimi, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi administrative, zyrat e arkivit të gjendjes civile pranë prefektit të qarkut, si dhe të gjitha institucionet, organet, personat juridikë apo fizikë që përpunojnë të dhëna personale në bazë të këtij udhëzimi.

14. Udhëzimi nr. 95, datë 7.4.2014, “Për përcaktimin e institucioneve dhe organeve që marrin të dhëna personale nga shërbimi i gjendjes civile, si dhe mënyrën, llojin dhe sasinë e informacionit që duhet të marrin”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Sandër Lleshaj

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E
INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E
TË DHËNAVE PERSONALE
Besnik Dervishi



ANEKS I

LISTA E INSTITUCIONEVE QË MARRIN INFORMACION, BAZA LIGJORE PËRKATËSE, LLOJI DHE SASIA E INFORMACIONIT QË JEP SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE DHE MËNYRA E VËNIES NË DISPOZICION TË KËTIJ INFORMACIONI

NR.	SUBJEKTET (KONTROLLUESIT) QË MARRIN TË DHËNA	BAZA LIGJORE	TË DHËNAT PERSONALE QË DUHET TË JEPEN NGA SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE NË PËRPUTHJE ME LEGJSLACIONIN PËRKATËS PËR	MËNYRA E VËNIES NË DISPOZICION TË INFORMACIONIT
1	Agjencia e Trajtimit të Kredive	Ligji nr. 8894, datë 14.5.2002, “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive”, i ndryshuar, neni 10.	Të dhënat si më poshtë: - emër; - mbiemër; - numër personal; - atësi; - amësi; - datëlindje; - vendbanimi (adresa).	Në formë shkresore, sipas kërkesës.
2	Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK)	Ligji nr. 111/2018, “Për kadastrën”, neni 68, “Bashkëpunimi ndërinstitucional”. Ligji 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, neni 27 “Dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e objektit”.	Të dhënat që përmban certifikata e lindjes dhe certifikata familjare.	Në formë shkresore, sipas kërkesës, si dhe në formë elektronike.



3	Autoritetet tatimore	Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 62, “Personat, të cilëve u adresohet kërkesa për të dhënë informacion”. Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 13, “Detyrimi për të paguar” deri 13/10. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 899, datë 14.12.2011, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 55, datë 3.2.2010 të Këshillit të Ministrave, Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, pika 5.4. Udhëzimi nr. 5, datë 30.1.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, pika 2.8	Të dhënat si më poshtë: - emër; - mbiemër; - numri personal; - atësi; - amësi; - vendbanimi (adresa).	Në formë elektronike.
4	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF)	Ligji nr. 9572, datë 3.7.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar - Neni 14 “Kompetencat e Bordit”, pika 2 dhe 22; - Neni 15 “Kompetencat e kryetarit të Bordit”; - Neni 18 “Procedura e ekzekutimit të të drejtave të Bordit dhe të strukturave të Autoritetit”, pika 6, paragrafi 4. Ligji nr. 10076, datë 12.2.2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, neni 38, “Krijimi i qendrës së informacionit të sigurimeve dhe lloji i të dhënave që duhet të administrojë”.	Të dhënat si më poshtë: - emër; - mbiemër; - atësi; - numri personal; - datëlindje; - gjinia; - vendbanimi (adresa).	Në formë elektronike.



5	Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit	Nenit 5, i ligjit nr. 45/2015, datë 30.4.2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.	Të dhënat si më poshtë: - emri; - mbiemri; - numri personal; - atësia; - amësia; - gjinia; - datëlindja; - vendlindje (qyteti, fshati); - vendbanimi (adresa); - gjendja civile; - mbiemri para/pas martese; - shtetësia; - bashkia /njësia administrative; - historikun e gjeneraliteteve të ndryshme gjatë viteve për periudhën kohore nga viti 1941–1991”	Në formë shkresore, sipas kërkesës, si dhe në formë elektronike.
6	Avokati i Popullit	Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar: - Neni 19, “Procedura e hetimit”; - Neni 20, “E drejta për të kërkuar informacione apo dokumente sekrete shtetërore”	Të gjitha të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj, por që kanë lidhje me hetimin.	Në formë shkresore, sipas kërkesës.
7	Avokatura e Shtetit	Ligji nr. 10018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar; Neni 16, “Marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet shtetërore”	Të gjitha të dhënat edomosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj dhe të vlerësuara në përputhje me qëllimin e përcaktuar në kërkesë.	Në formë shkresore, sipas kërkesës, si dhe në formë elektronike.
8	Banka e Shqipërisë	Ligji nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, pika 1, e nenit 24 dhe shkronja “a”, e nenit 29.	Të dhënat si më poshtë: - emër; - mbiemër; - numri personal; - atësia; - datëlindje; - gjinia; - vendbanimi (adresa).	Në formë elektronike.



9	Byroja Shqiptare e Sigurimit	Ligji nr. 10 076/2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar. Kodi i Procedurës Civile, neni 154. Rregullorja nr. 53/2009 e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, “Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”	Të dhënat si më poshtë: Vendbanimi (adresa)/vendqëndrimi për personat (shkaktarë/përfitues) të një procedure dëmshpërblimi.	Në formë shkresore, sipas kërkesës, si dhe në formë elektronike.
10	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve	Ligji nr. 8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar. Ligji nr. 10032, datë 11.12.2008, “Për policinë e burgjeve”, i ndryshuar. VKM-ja nr. 437, datë 20.5.2015, “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”: - neni 10, “Kushtet e pranimit të të dënuarve”; - neni 11, “Regjistrimi i të paraburgosurit apo i të dënuarit”; - neni 16, “Dosja personale”; - neni 17, “Regjistrat themeltarë të dënuarve dhe të të paraburgosurve”; - neni 40, pika “Takimet me familjen, të afërmit dhe miqtë”; - neni 53 “Lejet e veçanta”.	Të dhënat që ndodhen edhe në dokumentin e identifikimit të të dënuarit: - emër; - mbiemër; - numri personal; - atësi; - amësi; - datëlindje; - vendlindje; - vendbanimi (adresa); - çdo informacion tjetër që kërkohet për të plotësuar dokumentacionin e personit të privuar nga liria.	Në formë shkresore, sipas objektit të kërkesës.
11	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe degët doganore	Ligj nr. 102, datë 31.7.2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.	Të dhënat si më poshtë: - emër; - mbiemër; - numri personal; - atësi; - amësi; - datëlindje; - vendbanimi (adresa). - të gjitha të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj, që lidhen me çështjen në shqyrtim dhe me qëllimin.	Në formë shkresore, sipas kërkesës, si dhe në formë elektronike.



12	Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave	Ligji nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit”, i ndryshuar: - neni 21, “Organizimi i autoritetit përgjegjës”; - neni 22, “Detyrat dhe funksionet e autoritetit përgjegjës”.	Të dhënat si më poshtë: - emër; - mbiemër; - numri personal; - atësi; - amësi; - datëlindje; - vendlindje; - gjendja civile; - gjinia; - lidhja me kryefamiljarin; - përbërja familjare aktuale dhe historike.	Në formë shkresore, sipas kërkesës, si dhe në formë elektronike.
13	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor	Kodi Rrugor, miratuar me ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998, i ndryshuar. Udhëzimi nr. 1, datë 18.1.2012, “Për dokumentet e qarkullimit dhe të regjistrimit të mjeteve rrugore me motor dhe të rimorkiove të tyre”, i ndryshuar.	- numri personal; - emër; - mbiemër; - atësi; - mëmësi; - datëlindje; - vendlindje; - shteti i lindjes; - numri i letërnjoftimit ID; - lloji letërnjoftimit ID; - data e lëshimit të letërnjoftimit ID; - data e skadencës së letërnjoftimit ID; - adresa.	Në formë elektronike.



14	Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar	Ligji nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar ‘sekret shtetëror’”, i ndryshuar, pika 4, e nenit 25’ “Krijimi dhe detyrat” Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, germa “a”, neni 37, “Detyrat e grupit të punës”, neni 39, “Procedura për kontrollin e figurës”. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 04.03.2015 “Për miratimin e rregullores ‘Për sigurimin e personelit’”, pika 4, neni 3, “Përkufizime dhe parime të përgjithshme”: - neni 5, “Detyrimet e autoriteteve verifikuese dhe të institucioneve të tjera shtetërore”; - neni 10, “Dokumentacioni bazë i aplikimit për pajisje me CSP”; - neni 12, “Kushtet për fillimin e verifikimit të sigurisë”; - neni 13, “Kërkesat e përgjithshme të vlerësimit të sigurisë”; - neni 19, “Rrethi i personave që verifikohen”.	Të dhënat si më poshtë: - emër; - mbiemër (para ose pas martese); - numri personal; - atësi; - amësi; - datëlindje; - vendlindje; - vendbanimi (adresa); - gjendja civile; - të dhënat që përmban certifikata familjare; - shtetësia.	Në formë elektronike.
15	Enti Kombëtar i Banesave	Ligji nr. 22/2018, “Për strehimin social” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Akti normativ nr. 3, datë 1.3.2012, “Për lirin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuar”.	Të dhënat që përmban certifikata familjare, si më poshtë: - emër; - mbiemër; - numër personal; - atësi; - amësi; - datëlindja; - gjendja civile; - vendlindje; - shtetësi - vendbanimi (adresa).	Në formë shkresore, sipas kërkesës, si dhe në formë elektronike.



16	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor	Ligji nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”: - neni 5, “Personat e siguruar”; - neni 27, “Regjistrimi dhe identifikimi i personave të siguruar”, paragrafët 5 dhe 6.	Të dhënat që përmban: - certifikata personale; - certifikata familjare; - certifikata e lëshuar nga akti i vdekjes.	Në formë elektronike.
17	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave	Neni 9/1 dhe neni 26, i ligjit nr. 9046, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike”, i ndryshuar. Neni 9 dhe neni 42 i ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.	Të gjitha të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj/vlerësuar në përputhje me qëllimin e përcaktuar në kërkesë.	Në formë shkresore, sipas kërkesës.
18	Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH)	Ligji nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 42, “Pagesat për vdekje”. Pagesa për vdekje i jepet: a) një personi të siguruar ose një pensionisti në rast vdekjeje të një anëtarit të familjes që ai e ka në ngarkim; b) personi që u kujdes për personin e siguruar të vdekur, i cili pagoi shpenzimet e varrimit. Udhëzimi nr. 3912, datë 21.6.2004, “Mbi procedurat për përballimin nga shteti të shpenzimeve të shërbimit të varrimit për shtetasit shqiptarë, që vdesin brenda dhe jashtë shtetit”: “Ndihma në lekë tërhiqet nga të interesuarit pranë zyrës së financës në bashkinë apo komunën përkatëse kundrejt paraqitjes së certifikatës së vdekjes së të ndjerit me shënimin ‘Shpenzime varrimi’. Për çdo rast pagese, financa e bashkisë apo e komunës, sipas certifikatës së paraqitur, llogarit masën e ndihmës, si dhe plotëson mandatpagesën.”	Për të gjithë shtetasit shqiptarë, të cilët janë pjesë e skemës së sigurimeve shoqërore. Të dhënat që përmban certifikata e vdekjes, si më poshtë: - emër; - mbiemër para ose pas martese; - numër personal; - atësi; - amësi - data e lindjes; - vendlindje; - gjinia; - gjendja civile - shtetësia; - data e vdekjes; - vendi i vdekjes; - vendbanimi (adresa).	Në formë elektronike.
19	Instituti i Statistikave	Ligj nr. 17/2018, “Për statistikat zyrtare”	Të gjitha të dhënat personale që përmban RKGJC-ja.	Në formë elektronike.



20	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	Ligji nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar: - neni 27, “Zonat e administrimit zgjedhor”; - neni 46, “Regjistrimi i zgjedhësve në listat e zgjedhësve”; - neni 48, “Përmbajtja dhe formati i listës së zgjedhësve”; - neni 56, “Përgatitja dhe shpallja e listës së zgjedhësve”.	Të dhënat si më poshtë: - emër; - mbiemër; - numër personal; - atësi; - amësi; - datëlindje; - vendbanimi (adresa).	Në formë shkresore, sipas kërkesës, si dhe në formë elektronike.
21	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Ligji nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”. Neni 23, “Marrja dhe përdorimi i bazave të tjera të të dhënave”.	Të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj/vlerësuar në përputhje me qëllimin e përcaktuar në kërkesë.	Në formë shkresore, sipas kërkesës.
22	Ministria e Kulturës	Ligj nr. 8576, datë 3. 2. 2000, “Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Neni 28, “Bibliotekat publike”, pika 7.	Të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj/vlerësuar në përputhje me qëllimin e përcaktuar në kërkesë.	Në formë shkresore, sipas kërkesës.



23	Ministria e Mbrojtjes, Forcat e Armatosura dhe strukturat në varësi të tyre.	Ligji nr. 65/2014, “Për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes”, neni 15, pika 1. Ligj nr. 13/2015, “Për Policinë Ushtarake dhe Forcat e Armatosura në Republikën e Shqipërisë”: - neni 18, “Veprimtaria Informativë”; - neni 19, “Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave personale”. Ligji 45/2019, “Për mbrojtjen civile”; Ligji nr. 10142/2009, “Për sigurimet shoqërore të ushtarakut, punonjësve të gardës”; VKM 793, datë 24.9.2010, i ndryshuar, “Për zbatimin e ligjit nr. 10142/2009, Për sigurimet shoqërore të ushtarakut, punonjësve të gardës etj.”; Ligj nr. 9047, datë 10.7.2003, “Për shërbimin informativ ushtarak”; VKM nr. 103, datë 10.2.2016, “Për miratimin e planit të mobilizimit të përgjithshëm ose të pjesshëm të burimeve njerëzore e materiale të vendit gjatë periudhës për të cilën kërkohet vendosja e masave të jashtëzakonshme. Ligji nr. 80/2015 Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”	Të dhënat si më poshtë: - emër; - mbiemër; - numër personal; - atësi; - amësi; - datëlindje; - vendbanimi (adresa). Këto të dhëna u përkasin personave për të cilët ka filluar procedimi penal për vepra të parashikuara nga Kodi Penal dhe Kodi Penal Ushtarak.	Në formë shkresore, sipas kërkesës.
24	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Ligji nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”.	Të dhënat që përmban certifikata familjare.	Në formë elektronike.
25	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	Ligji nr. 9734, datë 14.5.2007, “Për turizmin” Neni 15, “Njësitë e qeverisjes vendore dhe detyrat e tyre për turizmin”. Neni 17, “Regjistri kombëtar i burimeve turistike”.	Të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj/vlerësuar në përputhje me qëllimin e përcaktuar në kërkesë.	Në formë shkresore, sipas kërkesës.
26	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	Ligji nr. 8372, datë 9.7.1998, “Për ushtrimin e funksioneve konsullore nga përfaqësitë diplomatike ose konsullore”.	Të gjitha të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj dhe vlerësuar në përputhje me qëllimin.	Në formë elektronike.



27	Organet e qeverisjes vendore	Ligj nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Neni 48, “Organi që harton dhe miraton listat”.	Të gjitha të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj dhe vlerësuar në përputhje me qëllimin e përcaktuar në kërkesë.	Në formë elektronike.
28	Përfaqësitë diplomatike të qeverive të huaja	Ligji nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, konkretisht nenet 8 dhe 9. Vendimi nr. 3, datë 20.11.2012, “Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”, i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.	Të dhënat e domosdoshme, të cilat vlerësohen të nevojshme për plotësimin e qëllimit. Marrësi në kërkesë përcakton qartë qëllimin e marrjes së të dhënave. Transferuesi i të dhënave vlerëson dhënien e sasisë së të dhënave në përputhje me qëllimin.	Në formë shkresore, sipas kërkesës.
29	Përfaqësuesit dhe avokatët me prokurë	Ligji nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, i ndryshuar, neni 3, “Karakterit personal i të dhënave”. Ligj nr. 55/2018 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, neni 11.	Të dhënat që kanë lidhje me personin që përfaqëson avokati dhe që kanë lidhje me çështjen ose personin që përfaqësohet ose mbrohet prej tij.	Në formë shkresore, sipas kërkesës.
30	Policia e Shtetit	Ligji nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar: - neni 124, “Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave personale”; - neni 129, “Detyrimi i institucioneve shtetërore dhe private për dhënie informacioni”.	Të gjitha të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj dhe vlerësuar në përputhje me qëllimin.	Në formë elektronike.



31	Prefektët	Ligji nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, pika , neni 8. Udhëzimi i Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 13.1.2010, “Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokat bujqësore të ish-NB-ve dhe të zonës së zhvillimit me përparësi turizmin”. Udhëzimi nr. 2, datë 13.1.2010, “Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, nga komisionet vendore të verifikimit të titujve të pronësisë, kur këtë e kërkojnë individë a institucione”.	Të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj/akt nënligjor vlerësuar në përputhje me qëllimin e përcaktuar në kërkesë.	Në formë shkresore, sipas kërkesës.
32	Prokuroria e Përgjithshme	Kodi i Procedurës Penale, i ndryshuar Neni 2, “Respektimi normave procedurale”	Të gjitha të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj, që lidhen me çështjen në shqyrtim dhe me qëllimin.	Elektronikisht, nëpërmjet ndërfaqes elektronike, të miratuar midis DPGJC-së dhe Prokurorisë, në zbatim të ligjit nr. 10325, datë 23.9. 2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”.
33	Shërbimi i Provës	Ligji nr. 8331, datë 21.4.1998, i ndryshuar me ligjin nr. 10024, datë 27.11.2008, “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, neni 31/7, “Shërbimi i provës”.	Të dhënat që përmban certifikata e vdekjes. Të dhënat që ndodhen në dokumentin e identifikimit të të dënuarit si: - emër; - mbiemër; - atësi; - mëmësi; - datëlindje; - vendlindje; - vendbanimi (adresa), si dhe çdo informacion tjetër që kërkohet për të plotësuar qëllimin.	Në formë shkresore, sipas kërkesës.



34	Shërbimi Informativ i Shtetit	Ligji nr. 8391, datë 28.10.1998, “Për Shërbimin Informativ Kombëtar”, i ndryshuar, neni 3.	Të dhënat si: - emri; - mbiemri; - atësia; - amësia; - numri personal; - datëlindja; - vendlindja; - vendbanimi (adresa); - statusi i gjendjes civile; - shtetësia; - kombësia; - të dhënat që përmban certifikata familjare; - mbiemri para/pas martesë i shtetasve të gjinive (f/m); - historiku i plotë/pa afat kohor i regjistrimit dhe ndryshimit të emrave/ gjeneraliteteve të shtetasit; - data e përditësimit të të dhënave.	Në formë elektronike.
35	Zyra vendore e Përmbartimit Përmbartuesi Gjyqësor Privat/Zyra e Përmbartimit Privat	Ligji nr. 8730, datë 18.1.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor” i ndryshuar, neni 26, “Mbledhja e të dhënave”. Ligji nr. 26, datë 8.5.2019, “Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat”, neni 36, “Të drejtat e përmbartuesit gjyqësor privat”.	Të gjitha të dhënat e domosdoshme për kryerjen e funksioneve të përcaktuara me ligj dhe të vlerësuar në përputhje me qëllimin e përcaktuar në kërkesë. Vetëm adresa/vendndodhja e debitorit.	Në formë shkresore, sipas kërkesës, si dhe në formë elektronike.
36	Noterët	Ligji nr. 110/2018, “Për noterinë”: - neni 62, “Kompetencat e noterit”; - neni 96, “Qasja dhe aplikimi nëpërmjet sistemit; elektronik në regjistrat elektronikë publikë”; - neni 112, “Përmbajtja e dëshmisë së trashëgimisë”; - neni 125, “Tërheqja e akteve të gjendjes civile pranë zyrave të gjendjes civile nga noteri dhe aplikimi nëpërmjet sistemit”.	Të gjitha të dhënat e domosdoshme për çeljen e trashëgimisë sipas përcaktimeve ligjore.	Në formë shkresore, sipas kërkesës, si dhe në formë elektronike.



ANEKS II

Protokolluar me nr. _____, datë _____.

FORMULAR

KËRKESË PËR MARRJEN E TË DHËNAVE PERSONALE NGA TË DHËNA TË ADMINISTRUARA
NGA SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE

Kërkuesi: Emri i institucionit/organit

Emri i titullarit të institucionit/organit

Adresa

Telefon

Drejtuar: Zyrës së Gjendjes Civile _____

Adresa: _____

Përmbajtja e kërkesës:

a) Lloji i të dhënave me karakter personal që kërkohet të merret nga të dhëna të administruara nga shërbimi i gjendjes civile

b) Baza ligjore mbi të cilën bazohet kërkesa (referencë të përmbledhësja e institucioneve dhe e organeve që marrin të dhëna me karakter personal nga të dhëna të administruara nga shërbimi i gjendjes civile)

c) Qëllimi për të cilin do të përdoren të dhënat me karakter personal të kërkuara

Emër, mbiemër dhe nënshkrimi i titullarit dhe vula e institucionit/organit

Datë _____. _____. _____



ANEKS III

DHËNIA E PËLQIMIT TË SUBJEKTIT PËR KONTROLL NË TË DHËNAT PERSONALE NË DOKUMENTACIONIN QË MBAN SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE

Unë _____, pas marrjes së informacionit të detajuar, në lidhje me natyrën dhe rëndësinë e përpunimit të të dhënave personale nga kontrolluesi, si dhe pas marrjes së informacionit të detajuar mbi të drejtat e mia të parashikuara në ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, jap pëlqimin tim të lirë për _____.

(Subjekti i autorizuar) të ketë të drejtën të kontrollojë të dhënat e mia personale, në lidhje me emrin, mbiemrin, datën e lindjes dhe (të dhëna të tjera sipas rastit), në dokumentacionin që mban shërbimi i gjendjes civile, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Qëllimi i këtij përpunimi do të jetë ekskluzivisht verifikimi i _____.

(Subjekti i autorizuar) _____, si kontrollues mund të përhapë ose të vërë në dispozicion të dhënat e mia personale të këta marrës: _____, me kusht që kjo përhapje të jetë absolutisht e nevojshme për përmbushjen e shërbimit të kërkuar ose nëse kontrolluesi kryen një përpunim që është thelbësor për përmbushjen e një detyrimi ligjor.

Kontrolluesi ka të drejtë të mbajë të dhënat e mia personale vetëm për një periudhë kohe prej ____ muajsh.

Kontrolluesi është i detyruar të shkatërrojë ose të bëjë anonime të dhënat e mia personale pas përfundimit të kësaj periudhe, përveç kur parashikohet ndryshe në bazë të një dispozite ose të një akti tjetër të veçantë.

Datë ____ . ____ . ____ Nënshkrimi _____

URDHËR

Nr. 349, datë 14.12.2020

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe të vendimit nr. 343, datë 21.7.1999, “Për krijimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor”,

URDHËROJ:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR) është autoriteti, të cilit i delegohet kompetenca e përfaqësimit të institucionit, në lidhje me zbatimin e pikës 3.7, “Procedura e dorëzimit në përfundim të kontratës koncesionare”, të Kontratës Koncesionare të datës 3.9.2009, “Për dhënien me koncesion të shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre në Republikën e Shqipërisë”.

2. DPSHTRR-ja ka të drejtë të kryejë çdo veprim procedural dhe administrativ të parashikuar në pikën 3.7, të Kontratës Koncesionare, si dhe çdo veprim tjetër administrativ të nevojshëm për t’u kryer, sipas legjislacionit në fuqi, pas përfundimit të procedurës së dorëzimit në përfundim të Kontratës Koncesionare.



3. DPSHTRR-ja të bëjë miratimin, pranimin dhe nënshkrimin e “Certifikatës së pranimit të dorëzimit”, sipas aneksit III, të Kontratës Koncesionare.

4. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

VENDIM

Nr. 622, datë 10.12.2020

PËR LËVIZJEN PARALELE, NGRITJEN NË DETYRË DHE PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të nenit 147/a, të “Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”; në pikën 2, shkronja “ë”, të nenit 61, në pikën 1, shkronja “ç”, të nenit 90, në nenin 97, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar; në nenet 54–62, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar; në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 71, datë 20.5.2019, “Për procedurën e funksionimit të mbledhjes së Këshillit të Gjykatës”, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky vendim përcakton rregulla të hollësishme për procedurën e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor.

Neni 2 Subjektet

Subjekte të këtij vendimi janë kandidatët për pozicionet e mëposhtme:

- a) kryesekretar;
- b) sekretar gjyqësor;
- c) nëpunës i financës dhe i buxhetit;
- ç) nëpunës të tjerë që punojnë në fushat e kërkimit ligjor dhe dokumentacionit;
- d) nëpunës të burimeve njerëzore;
- dh) nëpunës të teknologjisë së informacionit;
- e) nëpunës të arkivit;
- ë) nëpunës të marrëdhënieve me publikun, me medien dhe me jashtë;
- f) nëpunës të tjerë që punojnë në gjykata, sipas kërkesave dhe nevojave specifike për burimet njerëzore të gjykatave.

Neni 3 Përkufizime

Në këtë vendim termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

“Administrata gjyqësore” është struktura dhe tërësia e veprimtarive që synojnë organizimin dhe sigurimin e funksionimit të gjykatave.

“Ditë” janë ditët kalendarike, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë vendim.

“KLGJ” është Këshilli i Lartë Gjyqësor.

“Këshilli” është Këshilli i Gjykatës.

“KP” është Komisioni i Pranimit.

Ligji “Për pushtetin gjyqësor” është ligji nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

“Nëpunës civil gjyqësor” është personi, i cili ushtron funksione administrative publike brenda shërbimit gjyqësor ose administrativ të një gjykate, në mbështetje të drejtpërdrejtë të sistemit gjyqësor.

“Shërbim civil gjyqësor” është trupa e nëpunësve civilë gjyqësorë, që ushtron funksione administrative publike, brenda shërbimit gjyqësor ose administrativ të një gjykate, në mbështetje të drejtpërdrejtë të sistemit gjyqësor.



Neni 4

Radha e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor

1. Plotësimi i vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor i ofrohet nëpunësit, të regjistruar në listën e nëpunësve civilë gjyqësorë, i cili, sipas kësaj radhe:

- a) ka të drejtë të rikthehet në zbatim të një vendimi gjyqësor të formë së prerë;
- b) ka të drejtë të rikthehet, për shkak të pezullimit, sipas neneve 67 dhe 68, të ligjit “Për pushtetin gjyqësor”;
- c) ka të drejtë të transferohet, sipas nenit 66, të ligjit “Për pushtetin gjyqësor”.

2. Nëse vendi nuk mund të plotësohet sipas procedurës së referuar në pikën 1 të këtij neni, plotësimi bëhet nëpërmjet:

- a) procedurës së lëvizjes paralele;
- b) procedurës së ngritjes në detyrë;
- c) procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor.

Neni 5

Procedura e plotësimit të vendeve të lira, sipas listës së nëpunësve civilë gjyqësorë

1. Kancelari njofton KLGJ-në për vendin e lirë të krijuar në gjykatë ose që mund të krijohet në të ardhmen, në çdo rast, jo më vonë se dy javë pas vënies në dijeni.

2. KLGJ-ja, brenda 5 ditëve, vë në dijeni Këshillin, për nëpunësit civilë gjyqësorë të regjistruar në listën e nëpunësve civilë gjyqësorë, sipas kategorive të pikës 1, të nenit 4, të këtij vendimi.

3. Këshilli, brenda 5 ditëve, i ofron, me shkrim vendin e lirë të krijuar, kandidatit të regjistruar në listën përkatëse. Kandidati shpreh interesin për vendin e lirë, në formë të shkruar, brenda 5 ditëve nga njoftimi.

4. Nëse ka më shumë se një kandidat, Këshilli i ofron me shkrim vendin e lirë të krijuar secilit prej tyre. Nëse për të njëjtin vend, shprehin interesin më shumë se një kandidat, Këshilli përzgjedh kandidatin fitues, sipas radhës dhe kohës së dhënies së vendimit gjyqësor të formës së prerë apo përfundimit të kohës së pezullimit.

5. Kancelari njofton menjëherë KLGJ-në për rezultatet e procedurës sipas këtij neni.

KREU II

LËVIZJA PARALELE

Neni 6

Shpallja e njoftimit

1. Në rast se vendi i lirë nuk plotësohet, sipas nenit 5 të këtij vendimi, KLGJ-ja shpall fillimin e procedurës për lëvizje paralele. KLGJ-ja njofton të gjithë nëpunësit civilë gjyqësorë të së njëjtës kategori, të cilët plotësojnë kriteret për vendet e lira dhe hapjen e procedurave për lëvizje paralele. Njoftimi shpallet në të gjitha gjykatat dhe në faqen zyrtare të KLGJ-së.

2. Njoftimi për plotësimin e vendit të lirë në shërbimin civil gjyqësor me lëvizje paralele bëhet publik nga Këshilli dhe botohet të paktën 3 (tre) javë para datës së parashikuar për zhvillimin e konkurrimit dhe qëndron në faqen zyrtare të KLGJ-së dhe në faqen zyrtare të çdo gjykate, deri në përfundimin e procedurës së konkurrimit. Në shpallje përcaktohen:

- a) pozicioni i punës që është i lirë;
- b) përshkrimi i përgjithshëm i punës për atë pozicion;
- c) kushtet për lëvizjen paralele;
- ç) dokumentet që duhet të dorëzohen dhe mënyra e dorëzimit të tyre;
- d) afati i dorëzimit të dokumentacionit, i përcaktuar me datë të saktë kalendarike. Afati për paraqitjen e kërkesës për kandidim nuk mund të jetë më pak se dy javë nga data e njoftimit;
- dh) data e nxjerrjes së rezultateve për fazën e verifikimit paraprak të kushteve minimale të procedurës së lëvizjes paralele dhe të përmbushjes së kriterëve të veçanta të vendit të punës;
- e) data, vendi dhe ora e zhvillimit të intervistës;
- ë) fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë që do të vlerësohen në intervistë;
- f) procedura e vlerësimit të kandidatëve;
- g) data e nxjerrjes së rezultateve të konkurrimit;
- gj) mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët.

3. Pozicioni është i hapur për të gjithë nëpunësit civilë gjyqësorë të së njëjtës kategori në të njëjtën gjykatë apo në gjykata të tjera.



Neni 7

Kushtet për lëvizjen paralele

1. Nëpunësi civil gjyqësor i një kategorie të caktuar ka të drejtë të kandidojë me anë të lëvizjes paralele për pozicionet e së njëjtës kategori, brenda së njëjtës gjykatë ose në një gjykatë tjetër.

2. Kushtet minimale që duhet të plotësojë kandidati për këtë procedurë janë:

- a) të jetë nëpunës civil gjyqësor i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon;
- b) të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c) të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë”.

Neni 8

Procedura e lëvizjes paralele

1. Këshilli shqyrton dokumentacionin, përzgjedh dhe njofton kandidatin fitues brenda dy javëve nga përfundimi i afatit të paraqitjes së kërkesës për kandidim.

2. Procedura e lëvizjes paralele përfshin dy faza:

- a) verifikimi paraprak i kandidatëve, të cilët përmbushin kërkesat e përcaktuara në shpalljen për konkurrim;
- b) vlerësimi profesional i kandidatëve.

Neni 9

Verifikimi paraprak

1. Kancelari bën verifikimin paraprak të kandidatëve që përmbushin kushtet e lëvizjes paralele të përcaktuara në shpalljen për konkurrim, bazuar në dokumentacionin e paraqitur, jo më vonë se 2 (dy) ditë nga përfundimi i afatit të paraqitjes së kërkesave për kandidim.

2. Në rastin kur ka më shumë se një kandidat, që plotësojnë kërkesat e lëvizjes paralele, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim, kandidatët renditen në një listë, sipas rendit alfabetik. Lista e kandidatëve të kualifikuar administrohet nga kancelari dhe shpallet, brenda 2 (dy) ditëve, në faqen zyrtare të KLGJ-së si dhe në faqen zyrtare të çdo gjykate.

3. Kandidatët, që nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në shpalljen për konkurrim, renditen në një listë të veçantë, në të cilën tregohen edhe

arsyet e mosplotësimit të këtyre kërkesave. Lista administrohet nga kancelari dhe nuk bëhet publike. Kandidatët që nuk janë kualifikuar njoftohen elektronikisht nga kancelari për arsyet e moskualifikimit.

Neni 10

Ankimet

Kandidatët kanë të drejtë të bëjnë ankim me postë ose elektronikisht në Këshill, për rezultatet e verifikimit, brenda 2 (dy) ditëve nga data e njoftimit individual mbi rezultatin. Ankimet shqyrtohen brenda 2 (dy) ditëve nga data e depozitimit të ankimit.

Neni 11

Vlerësimi nga Këshilli i Gjykatës

1. Këshilli, brenda 2 (dy) ditëve nga përfundimi i verifikimit paraprak dhe i procedurave të ankimit, fillon vlerësimin profesional të kandidatëve. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100, si më poshtë:

a) 40 pikë për rezultatet e vlerësimit në punë. Në rast rezultatesh të njëjta, Këshilli krijon një renditje brenda grupit të kandidatëve me vlerësimin më të lartë të punës;

b) 50 pikë për vitet e përvojës profesionale në pozicionin përkatës, si dhe vitet e përgjithshme të përvojës profesionale në sektorin e drejtësisë ose përvojën profesionale që lidhet me fushën e pozicionit përkatës; si dhe

c) 10 pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse.

2. Këshilli, në përfundim të vlerësimit, i rendit kandidatët sipas pikëve të grumbulluara, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga vendimi i tij. Kancelari njofton individualisht me *email* kandidatët që kanë konkurruar për rezultatin e tyre.

Neni 12

Ankimet

Kandidatët kanë të drejtë të bëjnë ankim, me postë ose elektronikisht, në Këshill, për rezultatet e vlerësimit, brenda 2 (dy) ditëve nga data e njoftimit individual mbi rezultatin. Ankimet shqyrtohen brenda 2 (dy) ditëve nga data e depozitimit të ankimit.



Neni 13

Përfundimi i procedurës

1. Këshilli, brenda 24 (njëzet e katër) orëve, pas përfundimit të procedurave të ankimit, bën emërimin e kandidatit me më shumë pikë, nga lista e hartuar sipas pikës 2, të nenit 11, të këtij vendimi.

2. Këshilli, ku emërohet nëpunësi civil gjyqësor i ri, brenda 5 (pesë) ditëve nga përfundimi i procedurës së lëvizjes paralele, njofton KLGJ-në për rezultatet e procedurës. Njoftimi me emrat e nëpunësve fitues shpallet në faqen zyrtare të KLGJ-së dhe në faqen zyrtare të gjykatës.

3. Nëse asnjë nga kandidatët nuk ka fituar mbi 70 pikë, Këshilli përfundon me vendim procedurën pa asnjë të përzgjedhur dhe njofton KLGJ-në, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga marrja e vendimit.

Neni 14

Fillimi i detyrës

1. Kandidati fitues, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e nxjerrjes së aktit të emërimit, bën dorëzimet përkatëse për pozicionin e punës që ka pasur më parë.

2. Kandidati fitues paraqitet pranë gjykatës ku është emëruar, të nesërmen e datës së përfundimit të dorëzimit të detyrës pranë gjykatës së mëparshme.

3. Në rast se kandidati fitues nuk paraqitet, pa shkaqe të arsyeshme, brenda afatit të përcaktuar sipas pikës 1 të këtij neni, Kancelari njofton Këshillin brenda 2 (dy) ditëve pune. Në këtë rast Këshilli vijon procedurën me anulimin e aktit administrativ individual të emërimit, në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative.

4. Pas anulimit të aktit administrativ, vendi i lirë i ofrohet të renditurit të radhës në listën e kandidatëve, të hartuar sipas pikës 2 të nenit 11 të këtij vendimi, i cili ka fituar mbi 70 pikë. Kandidati jep pëlqimin, me shkrim, brenda 2 (dy) ditëve nga njoftimi.

5. Kryetari i Gjykatës, ku nëpunësi civil gjyqësor është emëruar, nxjerr aktin e fillimit të efekteve financiare, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga data e paraqitjes së tij në gjykatë.

KREU III

NGRITJA NË DETYRË

Neni 15

Kushtet dhe shpallja e njoftimit për ngritjen në detyrë

1. Nëpunësit civilë gjyqësorë, të cilët plotësojnë kriteret për një kategori më të lartë, kanë të drejtë të aplikojnë, nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë, në pozicionin e një kategorie më të lartë, brenda së njëjtës gjykatë ose në një gjykatë tjetër.

2. Shpallja e njoftimit për ngritjen në detyrë bëhet sipas procedurës së parashikuar në nenin 6 të këtij vendimi.

3. Kushtet minimale që duhet të plotësojë kandidati për këtë procedurë janë:

- a) të jetë nëpunës civil gjyqësor i konfirmuar;
- b) të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c) të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë”;
- d) si dhe kriteret e veçanta të parashikuara në nenin 56, pikat 4 - 8 të ligjit “Për pushtetin gjyqësor”.

Neni 16

Procedura e ngritjes në detyrë

1. Këshilli përzgjedh dhe njofton kandidatin fitues brenda dy javëve nga përfundimi i afatit të paraqitjes së kërkesës për kandidim.

2. Procedura e ngritjes në detyrë përfshin dy faza:

a) verifikimi paraprak i kandidatëve, të cilët përmbushin kushtet e ngritjes në detyrë dhe kërkesat e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim;

b) vlerësimi i kandidatëve, ku përfshihen vlerësimi i përvojës profesionale në punë, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse, si dhe rezultatet në punë.

Neni 17

Verifikimi paraprak

1. Kancelari bën verifikimin paraprak të kandidatëve që përmbushin kushtet e ngritjes në detyrë dhe kërkesat e veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim, dhe shqyrton kërkesat,



jo më vonë se 2 (dy) ditë nga data e mbylljes së pranimit të kërkesave.

2. Në rastin kur ka më shumë se një kandidat, që plotësojnë kushtet e ngritjes në detyrë dhe kërkesat e veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim, kandidatët renditen në një listë, sipas rendit alfabetik. Lista e kandidatëve të kualifikuar administrohet nga kancelari dhe shpallet, brenda 2 (dy) ditëve, në faqen zyrtare të KLGJ-së, si dhe në faqen zyrtare të çdo gjykate.

3. Kandidatët, që nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në shpalljen për konkurrim, renditen në një listë të veçantë, në të cilën tregohen edhe arsyet e mosplotësimit të këtyre kërkesave. Lista administrohet nga kancelari dhe nuk bëhet publike. Kandidatët që nuk janë kualifikuar njoftohen elektronikisht nga kancelari për arsyet e moskualifikimit.

Neni 18
Ankimet

Kandidatët kanë të drejtë të bëjnë ankim me postë ose elektronikisht në Këshill, për rezultatet e vlerësimit, brenda 2 (dy) ditëve nga data e njoftimit individual, mbi rezultatin. Ankimet shqyrtohen brenda 2 (dy) ditëve nga data e depozitimit të ankimit.

Neni 19
Vlerësimi nga Këshilli i Gjykatës

1. Këshilli, brenda 2 (dy) ditëve nga përfundimi i verifikimit paraprak dhe i procedurave të ankimit, fillon vlerësimin e kandidatëve dhe zhvillon një intervistë të strukturuar me gojë. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100.

2. Struktura e ndarjes së pikëve të vlerësimit të kandidatëve është si më poshtë vijon:

a) 70 pikë për dokumentacionin e dorëzuar, i ndarë:

i. 30 pikë për rezultatet e vlerësimit të punës. Në rast rezultatesh të njëjta, Këshilli krijon një renditje brenda grupit të kandidatëve me rezultatet më të larta;

ii. 30 pikë për vitet e përvojës profesionale në pozicionin përkatës, si dhe vitet e përgjithshme të përvojës profesionale në sektorin e drejtësisë ose

përvojën profesionale që lidhet me fushën e pozicionit përkatës;

iii. 10 pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse;

b) 30 pikë për intervistën e strukturuar me gojë.

3. Këshilli, në përfundim të vlerësimit rendit kandidatët sipas pikëve të grumbulluara, dhe brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga vendimi i tij, Kancelari njofton individualisht kandidatët që kanë konkurruar për rezultatin e tyre.

Neni 20
Ankimet

Kandidatët kanë të drejtë të bëjnë ankim, me postë ose elektronikisht, në Këshill, për rezultatet e vlerësimit, brenda 2 (dy) ditëve nga data e njoftimit individual mbi rezultatin. Ankimet shqyrtohen brenda 2 (dy) ditëve nga data e depozitimit të ankimit.

Neni 21
Përfundimi i procedurës

1. Këshilli, brenda 24 (njëzet e katër) orëve, pas përfundimit të procedurave të ankimit, bën emërimin për kandidatin me më shumë pikë, nga lista e hartuar sipas pikës 3, të nenit 19, të këtij vendimi.

2. Këshilli, ku emërohet nëpunësi civil gjyqësor i ri, brenda 5 (pesë) ditëve nga përfundimi i procedurës së ngritjes në detyrë, njofton KLGJ-në për rezultatet. Njoftimi shpallet në faqen zyrtare të KLGJ-së dhe në faqen zyrtare të gjykatës.

3. Nëse asnjë nga kandidatët nuk ka fituar mbi 70 pikë, Këshilli përfundon me vendim procedurën pa asnjë të përzgjedhur dhe njofton KLGJ-në, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga marrja e vendimit.

Neni 22
Fillimi i detyrës

1. Kandidati fitues, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e nxjerrjes së aktit të emërimit, bën dorëzimet përkatëse për pozicionin e punës që ka pasur më parë.



2. Kandidati fitues paraqitet pranë gjykatës ku është emëruar, të nesërmen e datës së përfundimit të dorëzimit të detyrës pranë gjykatës së mëparshme.

3. Në rast se kandidati fitues nuk paraqitet, pa shkaqe të arsyeshme, brenda afatit të përcaktuar sipas pikës 1 të këtij neni, Kancelari njofton Këshillin brenda 2 (dy) ditëve pune. Në këtë rast Këshilli vijon procedurën me anulimin e aktit administrativ individual të emërimit, në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative.

4. Pas anulimit të aktit administrativ, vendi i lirë i jepet të renditurit të radhës në listën e kandidatëve, të hartuar sipas pikës 3, të nenit 19, të këtij vendimi, i cili ka fituar mbi 70 pikë.

5. Kryetari i Gjykatës, ku nëpunësi civil gjyqësor është emëruar, nxjerr aktin e fillimit të efekteve financiare, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga dita e paraqitjes së tij në gjykatë.

KREU IV PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR

Neni 23

Dispozita të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil gjyqësor

1. Procedura e pranimin në shërbimin civil gjyqësor organizohet për të gjithë kategorinë e nëpunësve civil gjyqësorë, të përcaktuar në shkronjat “ç”–“e”, të nenit 50, të ligjit “Për pushtetin Gjyqësor”.

2. Kandidatët përzgjidhen nëpërmjet konkurrimit, që përfshin një test të shkruar dhe intervistën me gojë.

3. Lista e kandidatëve fitues të paemëruar, në përputhje me pikën 6, të nenit 54, të ligjit “Për pushtetin gjyqësor”, është e vlefshme për një periudhë dyvjeçare nga shpallja e fituesve. Lista përditësohet sa herë që organizohet një konkurs tjetër për të njëjtën kategori, duke renditur sërish kandidatët e paemëruar sipas rezultatit përfundimtar.

Neni 24

Shpallja e njoftimit

1. KLGJ-ja, jo më vonë se tri javë nga marrja e njoftimit për mosplotësimin e vendit të lirë, me anë të procedurave për lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë, shpall fillimin e procedurës për pranimin në shërbimin civil gjyqësor dhe i kërkon Kancelarit publikimin e shpalljes në faqen zyrtare të gjykatës.

2. Njoftimi e procedurës për plotësimin e një vendi të lirë në shërbimin civil gjyqësor bëhet nga Këshilli dhe botohet të paktën tre javë para datës së parashikuar për zhvillimin e konkurrimit dhe qëndron në faqen zyrtare të KLGJ-së dhe në faqen zyrtare të gjykatës, të paktën deri në përfundimin e procedurës së konkurrimit. Në shpallje përcaktohen:

- a) pozicionet e punës që janë të lira;
- b) fusha kryesore mbi të cilën do të bazohet konkurrimi, si dhe aftësitë dhe cilësitë që do të vlerësohen në konkurrim;
- c) fazat në të cilën do të kalojë konkurrimi, me shkrim dhe me gojë;
- ç) numri i vendeve të planifikuara për të cilat do të bëhet pranimi;
- d) kriteret e përgjithshme;
- dh) përshkrimi i përgjithshëm i punës, për të cilin do të zhvillohet konkurrimi;
- e) kriteret e veçanta;
- ë) dokumentet që duhet të dorëzohen dhe mënyra e dorëzimit të tyre;
- f) afati i dorëzimit të dokumentacionit i përcaktuar me datë të saktë kalendarike. Afati për paraqitjen e kërkesës së kandidimit nuk mund të jetë më pak se dy javë nga data e njoftimit;
- g) data e nxjerrjes së rezultateve për fazën e vlerësimit paraprak të kandidatëve;
- gj) mënyra e vlerësimit të kandidatëve në fazën e verifikimit paraprak, si dhe faza e vlerësimit të kandidatëve;
- h) mënyra e njoftimit dhe e komunikimit me kandidatët.

3. Pozicioni është i hapur për të gjithë kandidatët jashtë shërbimit civil gjyqësor. Dokumentacioni dorëzohet brenda datës së përcaktuar në shpalljen për konkurrim.



Neni 25

Kriteret e pranimit

1. Për pranimin në shërbimin civil gjyqësor, një kandidat duhet të plotësojë:

- a) kriteret e përgjithshme;
- b) kriteret e veçanta.

2. Kriteret e përgjithshme janë:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;

ç) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;

d) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

dh) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil apo shërbimi civil gjyqësor, që nuk është shuar sipas ligjit.

3. Kriteret e veçanta janë:

- a) për pozicionin e kryesekretarit:

i. të jetë i diplomuar në drejtësi në nivelin “Master profesional” ose të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë;

ii. të ketë përvojë profesionale jo më pak se pesë vjet, duke përfshirë së paku tre vjet përvojë pune si sekretar gjyqësor dhe/ose kryesekretar gjyqësor;

- b) për pozicionin e sekretarit gjyqësor:

i. të jetë diplomuar në drejtësi, të paktën në nivelin “Bachelor”;

ii. të ketë përvojë prej të paktën një vit të njohur si praktikë profesionale ose çdo lloj përvojë tjetër profesionale që lidhet me gjykatën;

c) për pozicionin e nëpunësit zbatues/drejtues i buxhetit punonjësi në detyrë duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara në legjislacionin përkatës për menaxhimin financiar dhe kontrollin, të cilët kanë përfunduar studimet e ciklit të dytë në “Master shkencor” ose zotëron diplomë universitare të ekuivalentuar me të, me përvojë pune jo më pak se pesë vjet në profesion;

ç) për pozicionin e nëpunësit/specialistit të financës dhe të buxhetit:

i. të jetë i diplomuar në shkenca ekonomike, të paktën në nivelin “Master shkencor” ose të barasvlershëm me të, ose “Master profesional”,

sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë;

ii. të ketë përvojë profesionale jo më pak se tre vjet në fushën e kontabilitetit dhe/ose menaxhimit të buxhetit.

d) për pozicionet drejtuese si nëpunës civil gjyqësor, në fusha të tjera të shërbimeve administrative të gjykatës:

i. të jetë i diplomuar në drejtësi, ekonomi ose teknologji e informacionit ose shkenca komunikimi/gazetari, ose në fusha të tjera të përshtatshme me përshkrimin e punës, të paktën në nivelin “Master shkencor” ose të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë;

ii. të ketë kryer të paktën një vit praktikë profesionale ose çdo lloj përvojë tjetër profesionale që lidhet me gjykatën.

dh) për pozicionet në gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale për korrupsionin dhe krimin e organizuar, duhet të plotësohen edhe kushtet e sigurisë, sipas kreut V të këtij vendimi.

Neni 26

Komisioni i Pranimit

1. KP ngrihet menjëherë me vendim të Këshillit, me shpalljen e vendit të lirë të krijuar dhe përbëhet nga 3 (tre) anëtarë:

- a) kancelari i gjykatës, i cili kryeson KP-në;

b) një përfaqësues nga KLGJ-ja, ekspert i fushës të njohurive mbi të cilën është shpallur konkurrimi;

c) nëpunësi gjyqësor në detyrë në gjykatë, i cili mundësisht të ketë njohuri të posaçme në fushën për të cilën është shpallur konkurrimi.

2. Pjesëmarrja e anëtarëve të caktuar, sipas pikës 1 të këtij neni, është e detyrueshme, me përjashtim të pengesave ligjore.

3. Në rast se ndonjë nga anëtarët e KP-së, ndodhet në kushtet e pengesës ligjore, ata zëvendësohen me nëpunës të tjerë të të njëjtit institucion, nga organet e emërtesës.

4. KP-ja merr vendime në praninë e të gjithë anëtarëve të tij. Nëse është e nevojshme, kancelari mund të caktojë pranë KP-së, një ose më shumë nëpunës të gjykatës, për të kryer veprimtarinë e mbështetjes teknike dhe të sekretariatit.



Neni 27

Procedura e pranimit

1. Konkurrimi për pranimin në shërbimin civil gjyqësor zhvillohet në dy faza:

a) verifikimi paraprak, nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, të publikuara në njoftim;

b) vlerësimi i kandidatëve.

2. Verifikimi paraprak bëhet nga Kancelari, ndërsa vlerësimi i kandidatëve bëhet nga KP-ja dhe Këshilli. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100, të cilat ndahen përkatësisht:

a) 60 pikë për vlerësimin me shkrim;

b) 40 pikë për vlerësimin nga Këshilli.

Neni 28

Verifikimi paraprak

1. Kancelari, në bazë të dokumentacionit të paraqitur, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e mbylljes të paraqitjes së kërkesave për kandidim, bën verifikimin paraprak të kandidatëve, që përmbushin kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

2. Në përfundim të verifikimit, sipas këtij vendimi, kandidatët, të cilët plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të pozicionit të punës, renditen në një listë sipas rendit alfabetik. Kancelari, njofton KP për datën e zhvillimit të vlerësimit të kandidatëve dhe për listën e kandidatëve.

3. Lista e kandidatëve të kualifikuar administrohet nga kancelari dhe shpallet në faqen zyrtare të KLGJ-së dhe në faqen zyrtare të gjykatës.

4. Kandidatët, që nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në shpalljen për konkurrim, renditen në një listë të veçantë, në të cilën tregohen edhe arsyet e mosplotësimit të këtyre kërkesave. Lista administrohet nga kancelari dhe nuk bëhet publike. Kandidatët që nuk janë kualifikuar njoftohen elektronikisht nga kancelari për arsyet e moskualifikimit.

Neni 29

Ankimet

Kandidatët kanë të drejtë të bëjnë ankim, me postë ose elektronikisht, në Këshill, për rezultatet e vlerësimit, brenda 2 (dy) ditëve nga data e njoftimit individual mbi rezultatin. Ankimet shqyrtohen brenda 2 (dy) ditëve nga data e depozitimit të ankimit.

Neni 30

Vlerësimi me shkrim nga Komisioni i Pranimit

1. KP-ja, 24 (njëzet e katër) orë përpara zhvillimit të fazës së vlerësimit me shkrim të kandidatëve, zgjedh një grup pyetjesh për testimin e fushës së njohurive, të aftësive dhe të cilësive të njoftuara në shpalljen për konkurrim.

2. Kandidati që grumbullon mbi 70% të pikëve nga vlerësimi me shkrim (42 pikë), kualifikohet për intervistën e strukturuar me gojë nga Këshilli.

3. KP-ja vendos përfundimin e procedurës pa asnjë të kualifikuar, në rast se asnjë nga kandidatët nuk ka marrë të paktën 42 pikë.

4. Kandidatët, që kanë marrë më pak se 42 pikë, renditen në një listë të posaçme, që nuk bëhet publike dhe njoftohen individualisht nga kancelari. Administrimi i kësaj liste, të nxjerrë nga KP-ja, bëhet nga kancelari.

5. Kancelari njofton individualisht kandidatët që kanë konkurruar për rezultatin e tyre, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga vendimi.

Neni 31

Ankimet

Kandidatët kanë të drejtë të bëjnë ankim, me postë ose elektronikisht, në Këshill, për rezultatet e vlerësimit, brenda 2 (dy) ditëve nga data e njoftimit individual mbi rezultatin. Ankimet shqyrtohen brenda 2 (dy) ditëve nga data e depozitimit të ankimit.

Neni 32

Vlerësimi nga Këshilli i Gjykatës

1. KP-ja i njofton Këshillit, brenda 24 (njëzet e katër) orëve, listën e kandidatëve të renditur, sipas pikëve apo përfundimin e procedurës pa asnjë të kualifikuar.



2. Kandidatët e renditur në listën e kandidatëve, kanë të drejtë të paraqesin kërkesë pranë Këshillit, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga marrja e njoftimit.

3. Këshilli, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga përfundimi i afatit të paraqitjes së kërkesave sipas pikës 2 të këtij neni, fton kandidatët për intervistë dhe zgjedh kandidatin për vendin e lirë përkatës, duke marrë parasysh kriteret sipas pikëzimit si vijon:

a) renditjen në listën e kandidatëve, sipas pikëve të vlerësimit me shkrim nga KP-ja;

b) 25 pikë për karakteristikat e veçanta të kandidatit në bazë të intervistës së strukturuar me gojë;

c) 15 pikë për vitet e përvojës profesionale në sektorin e drejtësisë ose përvoja të tjera profesionale që lidhen me vendin përkatës.

4. Nëse është e nevojshme, kancelari mund të caktojë pranë Këshillit, një ose më shumë nëpunës të gjykatës, për të kryer veprimtarinë mbështetëse teknike dhe të sekretariatit.

5. Kandidatët që marrin 70% të pikëve totale të vlerësimit kualifikohen për fazën e emërimit nga Këshilli.

Neni 33

Vendimi i Këshillit të Gjykatës

1. Këshilli arsyeton dhe publikon vendimin për rezultatet e procedurës së emërimit brenda 7 ditëve nga paraqitja e kërkesës sipas pikës 2, të nenit 32 të këtij vendimi. Vendimi i arsyetuar u njoftohet të gjithë kandidatëve. Kandidatët që nuk janë përzgjedhur kanë të drejtë të ankimojnë vendimin në gjykatën kompetente. KLGJ-ja dhe gjykata përkatëse shpallin në faqet e tyre të zyrtare, vendimin e shkurtuar.

2. Nëse konkurrohet për më shumë se një pozicion pune, Këshilli brenda 3 (tre) ditëve pas përfundimit të procedurës, i propozon pozicionet e lira kandidatit fitues, duke respektuar renditjen e tyre.

3. Këshilli, pas marrjes së mendimit me shkrim nga kandidati fitues, shpall fituesin dhe bën aktin e emërimit paraprak të tij. Këshilli, njofton pa vonesë KLGJ-në mbi rezultatet e procesit të pranimit.

Neni 34

Emërimi paraprak

1. Nëpunësi civil gjyqësor merr emërimin paraprak në shërbimin civil gjyqësor, me kusht që vendimi i emërimit të mos cenohet nga një vendim gjyqësor.

2. Në rast se nuk bëhet ankim brenda afatit, vendimi bëhet përfundimtar dhe emërimi paraprak konsiderohet përfundimtar që nga data e mbarimit të afatit të ankimit ndaj këtij vendimi.

3. Në rast se bëhet ankim dhe vendimi gjyqësor përfundimtar lë në fuqi vendimin e emërimit, emërimi paraprak konsiderohet përfundimtar, duke filluar nga dita e njoftimit të vendimit gjyqësor të nëpunësit civil gjyqësor të emëruar.

4. Në rast se gjykata e cenon vendimin e emërimit, Këshilli rivlerëson sipas rregullave të vlerësimit të gjitha kërkesat e kandidatëve në përputhje me ligjin dhe merr një vendim të ri pas dhënies së vendimit përfundimtar të gjykatës. Emërimi paraprak konsiderohet i përfunduar në datën e vendimit të ri të marrë nga Këshilli, i cili rishikon vendimin e emërimit, duke pasur parasysh vendimin përfundimtar të gjykatës. Kandidatët e emëruar paraprakisht dhe të sapoemëruar njoftohen në datën e dhënies së vendimit.

Neni 35

Fillimi i detyrës

1. Kandidati fitues brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e nxjerrjes së aktit të emërimit, bën dorëzimet përkatëse për pozicionin e punës që ka pasur më parë.

2. Kandidati fitues paraqitet pranë gjykatës ku është emëruar, të nesërmen e datës së përfundimit të dorëzimit të detyrës pranë gjykatës së mëparshme.

3. Në rast se kandidati fitues nuk paraqitet, pa shkaqe të arsyeshme, brenda afatit të përcaktuar, sipas pikës 1 të këtij neni, Kancelari njofton Këshillin brenda 2 (dy) ditëve pune. Në këtë rast, Këshilli vijon procedurën me anulimin e aktit administrativ individual të emërimit, në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative.



4. Pas anulimit të aktit administrativ, vendi i lirë i ofrohet të renditurit të radhës në vendimin e Këshillit për rezultatet e procedurës së emërimit.

5. Kryetari i Gjykatës, ku nëpunësi civil gjyqësor është emëruar, nxjerr aktin e fillimit të efekteve financiare, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga dita e paraqitjes së tij në gjykatë.

Neni 36

Periudha e provës

1. Viti i parë i shërbimit nga data e njoftimit të vendimit të emërimit paraprak, konsiderohet si periudhë prove, sipas nenit 62 të ligjit “Për pushtetin gjyqësor”.

2. Gjatë periudhës së provës, nëpunësi civil gjyqësor kryen detyrat nën kujdesin e një nëpunësi të vjetër civil gjyqësor të së njëjtës kategori ose të një kategorie më të lartë.

3. Gjatë periudhës së provës nëpunësi ndjek:

a) trajnimin në Programin e Formimit Fillestar, organizuar nga KLGJ-ja dhe/ose Shkolla e Magjistraturës;

b) udhëzimet e nëpunësit më të vjetër civil, nën kujdesin e të cilit ai është vendosur.

Neni 37

Përfundimi i periudhës së provës

1. Këshilli deklaron me vendim përfundimin e periudhës së provës. Vendimi mbi përfundimin e periudhës së provës merret bazuar, në:

a) rezultatit e testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit në KLGJ dhe/ose në Shkollën e Magjistraturës;

b) vlerësimin e rezultateve individuale në punë, i cili bëhet sipas procedurave të përcaktuara në vendimin e KLGJ-së për vlerësimin e arritjeve në punë.

2. Vendimi i Këshillit mbi përfundimin e periudhës së provës duhet të jetë i arsyetuar dhe i njoftohet nëpunësit nga Kancelari, brenda 3 (tri) ditëve pune nga data e marrjes së vendimit.

3. Në rast se Këshilli vendos të ndërpresë marrëdhënien e punës për nëpunësin civil gjyqësor të emëruar paraprakisht, gjatë periudhës së provës, njofton kandidatët e tjerë që kanë paraqitur kërkesë për vendin përkatës. Këta kandidatë mund të paraqesin kërkesën e tyre edhe në rastin kur ka mbaruar afati i listës së

kandidatëve në të cilën ata janë përfshirë. Në rastet kur kandidatët kanë paraqitur ankim, ky ankim konsiderohet i tërhequr. Organi kompetent fton të gjithë kandidatët e tjerë nga lista përkatëse e kandidatëve për të paraqitur kërkesë për kandidim për vendin përkatës.

Neni 38

Vendimi i Këshillit pas periudhës së provës

1. Në fund të periudhës së provës, Këshilli, ku është emëruar nëpunësi civil gjyqësor, vendos:

a) konfirmimin e nëpunësit civil gjyqësor;

b) zgjatjen e periudhës së provës një herë të vetme, deri në gjashtë muaj, nëse për arsye të justifikuara, ka qenë i pamundur vlerësimi i nëpunësit civil gjyqësor;

c) moskonfirmimin e nëpunësit civil gjyqësor.

2. Vendimi, sipas pikës 1 të këtij neni, bazohet në çdo rast në rezultatit e testimit dhe vlerësimit të rezultateve individuale të punës.

3. Këshilli i përcjell vendimin KLGJ-së brenda tri ditëve nga marrja e tij. KLGJ-ja regjistron vendimet e marra, sipas këtij neni, në Regjistrin Qendror të Personelit, brenda dhjetë ditëve nga marrja e njoftimit për vendimin.

4. Në rastin e vendimit të konfirmimit të nëpunësit civil gjyqësor, Këshilli nxjerr aktin e dhënies së statusit të nëpunësit civil gjyqësor brenda 10 (dhjetë) ditëve nga përfundimi i periudhës së provës.

Neni 39

Emërimi i përkohshëm

1. Kandidatët, në listën e kandidatëve të paemëruar ende në ndonjë pozicion sipas këtij vendimi, mund të emërohen nga Këshilli në mënyrë të përkohshme, në një pozicion pune, i cili për arsye të parashikuara nga ligji është i lirë përkohësisht.

2. Këshilli, përzgjedh kandidatin fitues që ka mbetur në listën e kandidatëve dhe që u përshtatet kërkesave të vendit të punës. Përzgjedhja dhe njoftimi i kandidatëve bëhet, sipas pikëve, në bazë të renditjes së tyre në listën e kandidatëve.

3. Këshilli nxjerr aktin e emërimit të përkohshëm në pozicionin e punës të propozuar,



brenda 3 (tri) ditëve kalendarike, nëse kandidati jep pëlqimin për emërimin e përkohshëm.

4. Emërimi i një kandidati në mënyrë të përkohshme nuk i heq atij të drejtën për t'u emëruar në mënyrë të përhershme në rast të krijimit të një pozicioni pune të lirë, gjatë kohës së vlefshmërisë së listës.

5. Me përfundimin e emërimit të përkohshëm, kandidati detyrohet të bëjë dorëzimet përkatëse brenda 5 (pesë) ditëve pune.

6. Emërimi i përkohshëm, pavarësisht kohëzgjatjes së tij, nuk konsiderohet periudhë prove, në rast se kandidati emërohet më pas në pozicion pune në mënyrë të përhershme.

7. Procedura e parashikuar sipas këtij neni, ndiqet vetëm pasi të ezaurohet ofrimi i vendit të lirë përkohësisht, nëpunësve civilë gjyqësorë të regjistruar në listën e administruar nga KLGJ-ja.

8. Nëpunësit e emëruar në mënyrë të përkohshme u nënshtrohen rregullave të procedimit disiplinor sipas legjislacionit për nëpunësin civil gjyqësor.

KREU V

KUSHTET E SIGURISË DHE PROCEDURAT SHITESË TË VERIFIKIMIT TË KANDIDATËVE PËR NËPUNËS CIVIL GJYQËSOR NË GJYKATAT E POSAÇME PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

Neni 40

Kushtet e sigurisë

1. Kandidati për nëpunës civil gjyqësor që kandidon për një nga pozicionet e lira në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, me anë të procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë apo pranimit në shërbimin civil gjyqësor, duhet të plotësojë edhe kushtet shitesë të sigurisë përpara se të emërohet në një nga këto pozicione. Asnjë kandidat nuk mund të emërohet në detyrë pa plotësuar këto kushte. Nga kjo rregull bën përjashtim kandidati, i cili në momentin e kandidimit, është i emëruar në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar.

2. Kushtet e sigurisë para emërimit në detyrë janë:

a) kontrolli i verifikimit të pasurisë dhe të figurës;

b) dhënia e pëlqimit për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake; si dhe

c) dhënia e pëlqimit prej anëtarëve të afërt të familjes për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake.

Neni 41

Aktet shitesë që i bashkëlidhen kërkesës për kandidim

1. Kandidati, bashkë me kërkesën për aplikim, plotëson dhe dorëzon pranë Këshillit përkatës së gjykatës së posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, aktet si më poshtë:

a) deklaratën e kontrollit të pasurive dhe të konfliktit të interesit, sipas formularit “Deklaratë e pasurisë dhe e interesave privatë të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë”. Nëse gjatë 180 ditëve para se të paraqiste kërkesën, kandidati ka kaluar një kontroll të kryer prej Inspektoratit të Lartë të Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, i cili nuk ka rezultuar në disfavor të tij, atëherë ky kriter do të konsiderohet si i përmbushur;

b) deklaratën për kontrollin e figurës, së bashku me deklaratën e vërtetësisë së të dhënave dhe deklaratën për dhënien e pëlqimit për mbledhjen, kryerjen e kontrollit, aksesin dhe administrimin e të dhënave personale, sipas shtojcës A, të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”;

c) vetëdeklarimin e kandidatit, sipas shtojcës B2 të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”;

ç) vetëdeklarimin e anëtarëve të familjes së kandidatit, sipas shtojcës B3, të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

2. Bashkë me njoftimin për plotësimin e vendit të lirë në gjykatat e posaçme për korrupsionin dhe krimin e organizuar, sipas neneve 6, 15 pika 2, dhe 24 të këtij vendim, Këshilli publikon dhe formularë të aksesueshem *online*, që duhet të plotësohen nga kandidatët, si dhe çdo informacion të nevojshëm për mënyrën e plotësimit të tyre.



Neni 42

Procedura shtesë e verifikimit të kushteve të sigurisë

1. Kancelari, gjatë fazës së verifikimit paraprak, verifikon edhe rregullsinë e plotësimit dhe të dorëzimit të akteve nga kandidatët, sipas pikës 1, të nenit 41, të këtij vendimi. Mosplotësimi dhe mosdorëzimi i tyre, përbën shkak për moskualifikim të kandidatit për fazat e tjera të procedurës.

2. Këshilli, jo më vonë se 2 (dy) ditë nga përfundimi i fazës së vlerësimit, i rendit kandidatët që kanë fituar mbi 70% të pikëve, në një listë sipas rendit alfabetik dhe ia dërgon atë, së bashku me aktet e plotësuara dhe të depozituara rregullisht, sipas pikës 1, të nenit 41, Komisionit të Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve.

3. Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve kryen verifikimet e nevojshme për pasurinë dhe figurën dhe, brenda 120 ditëve, i dorëzon Këshillit, një raport të hollësishëm mbi ligjshmërinë e burimeve të pasurisë dhe pastërtinë e figurës, si dhe çdo dokumentacion tjetër mbështetës të paraqitur nga vetë kandidatët apo institucionet shtetërore.

4. Kur është rasti, raporti i Komisionit të Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve mbi ligjshmërinë e burimeve të pasurisë dhe mbi pastërtinë e figurës së kandidatit, i njoftohet kandidatit brenda 2 (dy) ditëve nga depozitimi i tij.

5. Këshilli shqyrton brenda 5 (pesë) ditëve rezultatet e kontrollit, gjetjet dhe përfundimet e raportit të Komisionit të Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve. Në varësi të rezultateve të kontrollit dhe nevojave të verifikimit të mëtejshëm të pasurisë dhe figurës, Këshilli mund të kërkojë:

a) raport shtesë nga Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve, brenda një afati 5-ditor (pesëditor).

b) shpjegime me shkrim nga kandidati, duke e ftuar për të dhënë sqarime dhe për të paraqitur çdo dokumentacion mbështetës që vlerëson të nevojshëm, brenda një afati 5-ditor (pesëditor).

6. Kur kandidati paraqet shpjegime dhe dokumente mbështetëse që kundërshtojnë rezultatet e raportit të Komisionit të Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve,

ato i dërgohen brenda 2 (dy) ditëve këtij të fundit, duke iu kërkuar trajtimi i tyre dhe bërja e një raporti shtesë.

Neni 43

Vendimi i Këshillit në përfundim të procedurës së verifikimit

1. Në përfundim të procedurës së verifikimit të kushteve të sigurisë, në varësi të rezultateve, Këshilli vendos në lidhje me kualifikimin ose moskualifikimin e kandidatit.

2. Këshilli vendos emërimin e kandidatit, që është kualifikuar për kushtet e sigurisë dhe që ka fituar më shumë pikë në fazën e vlerësimit.

3. Këshilli vendos moskualifikimin e kandidatit, bazuar në rrethanat konkrete dhe respektim të parimit të proporcionalitetit, në rastin kur të dhënat, e marra nga burime të ligjshme, tregojnë se:

a) deklarimi nuk është i saktë dhe në përputhje me ligjin;

b) kandidati nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;

c) kandidati ka kryer fshehje të pasurisë;

ç) kandidati ka kryer deklaram të rremë;

d) kandidati gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

4. Moskualifikimi i kandidatit, sa i përket figurës vendoset nga Këshilli, në rastet kur nga informacionet dhe raportimet, tregohet se kandidati:

a) ka lidhje ose kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

b) ka shfaqur sjellje serioze joetike ose mungesë të theksuar integriteti, në atë masë sa nuk garanton besimin e publikut te sistemi i drejtësisë;

c) është në kushtet e ndalimit, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

5. Këshilli, në procedurën e përzgjedhjes dhe të emërimit të kandidatit për në gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, krahas procedurës së parashikuar në këtë krye, zbaton edhe procedurat e parashikuara në këtë vendim, sipas rastit, për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor.

KREU VI
DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 44

Rregulla më të detajuara mbi zbatimin e këtij vendimi, në lidhje me krijimin e KP-së, mënyrën e pikëzimit dhe të dokumentimit të procesit të vlerësimit, si dhe procedurat e tjera të vlerësimit, përcaktohen me udhëzim të Këshillit Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETAR
Naureda LlagamiVENDIM
Nr. 201, datë 2.12.2020**MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË
SHOQËRISË GSA SHPK, ME NR. 321,
SERIA T11/15, NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”; nenit 5, pika 1, germa “e”; nenit 8, nenit 9, nenit 13, dhe nenit 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe nenit 15, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 2.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 125/1 prot., datë 27.11.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, për rinovimin e licencës së shoqërisë GSA sh.p.k., në veprimtarinë e tregutit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 181, datë 6.11.2020, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë GSA sh.p.k. nr. 321, seria T11/15, në veprimtarinë e tregutit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e

Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 57, datë 22.6.2011, dhe rinovuar me vendimin nr. 160, datë 28.12.2015.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje u krye njoftimi në median e shkruar, me shkresën nr. 62/34 prot., datë 9.11.2020, dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria GSA sh.p.k.

- Me shkresën nr. 1184 prot., datë 9.11.2020, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria GSA sh.p.k., me shkresën nr. 1184/1 prot., datë 17.11.2020, ka përcjellë dokumentacionin e munguar.

- Kjo shoqëri është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Në datën 30.6.1993, është e regjistruar pranë QKB-së, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.).

- Shoqëria GSA sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 321, seria T11/15, të veprimtarisë së tregutit të energjisë elektrike që prej datës 22.6.2011, dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 57, me afat vlefshmërie deri në datën 22.6.2016, të rinovuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 160, datë 28.12.2015, për pesë vjet të tjera.

- Shoqëria GSA sh.p.k. ka aplikuar brenda afatit ligjor të nevojshëm për rinovimin e licencës.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për rinovimin e licencës së tregutit të energjisë elektrike, si dhe ka kryer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Aplikimi i shoqërisë GSA sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim (neni 9, pika 1, germa: “a”, “b” “c”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germa: “a”, “b”, “c”, “d”),



“e”), është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat: “a”, “b”, “c”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;

- dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, germat: “a”, “b”, “c”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën nr. 321, seria T11/15, të shoqërisë GSA sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 57, datë 22.6.2011, i ndryshuar, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar), duke filluar nga data 23.6.2021.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 202, datë 2.12.2020

MBI MIRATIMIN E “RREGULLORES PËR PROCEDURAT E SHITJES SË TEPRICAVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE, NË TREGUN E PARREGULLUAR, PËR SHOQËRINË PUBLIKE TË FURNIZIMIT”

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 19, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 11, pikat 2 dhe pika 3, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike,

të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 15 dhe nenit 26, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) në mbledhjen e tij të datës 2.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike nr. 123-7 prot., datë 25.11.2020, mbi kërkesën e FTL sh.a. për miratimin e “Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- VKM nr. 244/2016, e ndryshuar, me VKM-në nr. 883, datë 27.12.2019, përcaktoi ndër të tjera se: “Në rast të tepricave të krijuara ato do të tregtohen në treg të parregulluar me çmimin që ofron ky treg, në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara, bazuar në rregulloren për tregtimin e energjisë elektrike, që miratohet me vendim të Entit Rregullator të Energjisë”.

- Bordi i ERE-s, pas kërkesës së FTL sh.a., me vendimin nr. 136, datë 21.8.2020, vendosi fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e “Rregullores për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar, për shoqërinë publike të furnizimit”.

- Drafti i rregullores u publikua për konsultime dhe u dërgua për opinion nëpërmjet shkresës nr. 1072 prot., datë 31.8.2020, në palët e interesit: i. Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë; ii. Autoritetin e Konkurrencës, Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a.; iii. Operatorin e Sistemit të Transmetimit; iv. Furnizuesin e Tregut të Lirë sh.a.; v. Shoqatën Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike; vi. Shoqatën për Mbrojtjen e Tregtarëve dhe Tregut; vii. Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, për dhënien e opinioneve dhe komenteve përkatëse brenda 30 ditëve nga marrja dijeni nëpërmjet shkresës së sipërcituar.

- Në përgjigje të shkresës nr. 1072 prot., datë 31.8.2020, Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES), me shkresën nr. 14 prot., datë 30.9.2020, ka parashtruar ndër të tjera, si më poshtë vijon:

1. Të përcaktohet qartësisht ndalimi i çdo procedure të optimizimit/negocimit ndërmjet



shoqërisë publike të furnizimit, si dhe pjesëmarrësve në procedurën e shitjes;

2. Rregullorja të trajtojë të gjitha tepricat e FTL sh.a. dhe jo vetëm ato që burojnë nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike.

- Për sa i përket pikës së parë, ERE vlerëson se parashtrimi i bërë nga AAES, në propozimin e pikës 1 më sipër, garantohet në përcaktimet e pikës 7.2 të rregullores. Në të njëjtën kohë dhe përcaktimet e pikës 7.3 të rregullores garantojnë pandryshueshmërinë e kërkesës për ofertë që bëhet nga shitësi. Duke qenë se përcaktimet e sipërcituara garantojnë pandryshueshmërinë e ofertave që bëhen nga pjesëmarrësit në këto procedura, por edhe pandryshueshmërinë e kërkesës për ofertë, propozimi i bërë nga AAES, në pikën 1, më sipër, konsiderohet i ezauruar.

- Për sa i përket pikës së dytë, vlerësojmë se propozimi i bërë nga AAES, për t'i dhënë mundësinë FTL sh.a. të shesë në treg të gjitha tepricat e FTL sh.a. dhe jo vetëm ato që burojnë nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, por edhe tepricat që gjenerohen nga fluktracionet e gjenerimit dhe/ose konsumit të energjisë elektrike, konstatohet se bie ndesh me pikën tre (3), në nenin 11, të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, të ndryshuar. Në këto kushte propozimi i bërë nga AAES, në pikën 2, të parashtruar më sipër, nuk pranohet.

- Veç sa më sipër, në vlerësimet e bëra përgjatë procesit të shqyrtimit të draftit të “Rregullores për procedurat e shitjes së tepcave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar, për shoqërinë publike të furnizimit”, vlerësohen të nevojshme ndryshimet e mëposhtme:

- në nenin 1, baza ligjore e draftit të propozuar, janë bërë korrektime të përkatëse, kjo rregullore bazohet në përcaktimet e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 19, germa “l”, nenit 62, pika 2, nenit 69, germa “ë”, si dhe vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, i ndryshuar;

- në nenin 4, pika 2, në draftin e propozuar të rregullores ndryshohet përcaktimi i termit “Autoritet Kontraktor” me termin “shitësi”;

- në nenin 4, pika 4, ndryshon si vijon: “‘Tregtar i energjisë elektrike’ do të konsiderohet çdo person juridik/shoqëri vendase që ushtron aktivitet të licencuar, për tregtimin e energjisë elektrike, në vendin tonë, sipas legjislacionit në fuqi, si dhe çdo

shoqëri e huaj që ushtron aktivitetin në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 3 dhe 4, të ‘Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike’, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109/2016, të ndryshuar.”;

- në nenin 7, formati i ofertave, pika 3, shtohet paragrafi: “Kjo nuk duhet të dëmtojë mundësinë e tregtarëve të energjisë elektrike për të paraqitur oferta, të cilat janë më pak se kapaciteti maksimal që është siguruar”;

- në nenin 10, dokumentacioni ligjor dhe administrative, shtohet pika “d”: “Dokumentet e parashtruara në pikën “c” të këtij neni, do të përtërihen nga të gjithë pjesëmarrësit e regjistruar, brenda muajit dhjetor të çdo viti dhe do të jenë të vlefshëm për vitin pasardhës. Në çdo rast dhe në çdo kohë shitësi mund t'i kërkojë pjesëmarrësve të regjistruar, paraqitjen brenda 30 ditëve dhe jo më shumë se 3 herë në vit, të secilit nga dokumentet e parashikuara në pikën “c” të këtij neni, me qëllim verifikimin e statusit ligjor të subjektit. Mos dërgimi i dokumentacionit të kërkuar brenda afatit të përcaktuar, sjell për pasojë çregjistrimin e pjesëmarrësit të licencuar nga regjistri i shitësit;

- në nenin 18, monitorimi i shitjes së tepcave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, në pikën 2, duke pasur në konsideratë dhe përcaktimet e rregullores së blerjeve të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 103, datë 23.6.2016, të ndryshuar, vendoset një afat ku shitësi deri në datën 5 të çdo muaji paraqet në ERE një kopje të raportit përmbledhës përfundimtar për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave dhe një kopje të të gjitha ankesave të paraqitura, nëse ka, si dhe përgjigjet për ankesat për muajin paraardhës.

1. Neni 18, pika 5, ndryshon: Në rast se ERE shikon parregullsi në raportet e paraqitura, sipas pikës 2 të këtij neni, të cilat mund t'i ngarkohen shitësit dhe/ose ofertuesve, ERE mund të caktojë masë administrative mbështetur në nenin 20, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Në nenin 18, pika 6, e cila i referohet FTL sh.a. në rolin e blerësit dhe jo të shitësit është i pasaktë. Në këto kushte hiqet përcaktimi i pikës 6 nga drafti i rregullores së propozuar.



- Rregullorja është një dokument i plotë dhe trajton në tërësinë e saj të gjithë procesin e tregimit të tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e “Rregullore për procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar, për shoqërinë publike të furnizimit në tregun e lirë, FTL sh.a.” (bashkëlidhur).

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë FTL sh.a. dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

RREGULLORE PËR PROCEDURAT E SHITJES SË TEPRICAVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE, NË TREGUN E PARREGULLUAR, PËR SHOQËRINË PUBLIKE TË FURNIZIMIT NË TREGUN E LIRË

Dispozita të Përgjithshme

Neni 1 Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në zbatim të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 19, germa “I”, nenit 62, pika 2, nenit 69, germa “ë”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar.

Neni 2 Objekti dhe qëllimi

1. Objekti i kësaj rregulloreje është të përcaktojë procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike, nga Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a., si shoqëri e licencuar në sektorin e energjisë elektrike, që ushtron aktivitetin e tregimit dhe furnizimit me energji elektrike.

2. Qëllimi i kësaj rregulloreje, është:

a) të përcaktojë procedura eficiente dhe praktike për shoqërinë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a., për tregtimin në treg të parregulluar, të tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara në këtë rregullore;

b) të sigurojë shitje të energjisë elektrike me çmime sa më të larta;

c) të nxisë pjesëmarrjen e tregtarëve në procesin e shitjes së energjisë elektrike;

d) të nxisë konkurrencën në procesin e shitjes së energjisë elektrike;

e) të sigurojë transparencë, si dhe mundësi të barabarta për të gjithë tregtarët dhe pjesëmarrësit në procedurat e shitjes së energjisë elektrike;

f) të përputhet me legjislacionin në fuqi.

Neni 3 Parimet

Procedurat e shitjes së tepricave të energjisë elektrike, të prodhuara nga prodhuesit me përparësi, sipas kësaj rregulloreje, do të realizohen në përputhje me parimet e barazisë, konkurrencës, transparencës dhe parimet e ruajtjes së konfidencialitetit.

Neni 4 Përcaktime

Në këtë rregullore, termat e përdorur më poshtë do të kenë kuptimin e përcaktuar më poshtë:

1. “ERE” nënkupton Entin Rregullator të Energjisë, përgjegjës për sektorin e energjisë elektrike dhe gazit, i cili funksionon në përputhje me ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në fuqi;



2. “Shitësi” nënkupton Furnizuesin e Tregut të Lirë sh.a., për të cilin është vendosur detyrimi i shërbimit publik, për shitjen e tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, sipas përcaktimeve ligjore dhe licencave të lëshuara nga Enti Rregullator i Energjisë;

3. “Shitje e tepricave të energjisë elektrike të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike” do të thotë kalimi në sasi dhe në kohë i tepricës së energjisë elektrike, nga shitësi te tregtarët e energjisë elektrike dhe/ose bursat energjetike, sipas pagesës dhe kushteve të tjera të përcaktuara në kontratën përkatëse të shitjes dhe sipas procedurave të përcaktuara në këtë rregullore.

4. “Tregtar i energjisë elektrike” do të konsiderohet çdo person juridik/shoqëri vendase që ushtron aktivitet të licencuar për tregtimin e energjisë elektrike, në vendin tonë, sipas legjislacionit në fuqi, si dhe çdo shoqëri e huaj e cila ushtron aktivitetin në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 3 dhe 4, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109/2016, të ndryshuar;

5. “Ftesa për ofertë” është dokumenti zyrtar që shitësi u drejton publikisht tregtarëve të energjisë elektrike për paraqitje të ofertave, për shitje të energjisë elektrike, hartuar në konformitet me formën e parashikuar në këtë rregullore;

6. “Kode të funksionimit të rrjetit” konsiderohen Kodi i Rrjetit të Transmetimit, Kodi i Rrjetit të Shpërndarjes, si dhe Kodi i Matjes;

7. “Ofertues” do të konsiderohet subjekti tregtar i energjisë elektrike që paraqet një ofertë;

8. “Ofertë” do të konsiderohet tërësia e informacionit dhe e korrespondencës së dërguar në mënyrë elektronike nga ofertuesi, e cila administrohet nga Autoriteti Kontraktor sipas rregullave në fuqi;

9. “Kalendari i ofertave” do të konsiderohet renditja kalendarike që përfshin sipas një radhe të miratuar, të gjitha datat në të cilat organizohen proceset e shitjes së energjisë elektrike. Ky “Kalendar i Ofertave” përditësohet dhe bëhet transparent duke u vendosur në dispozicion të publikut. Çdo ndryshim në kalendarin e ofertave njoftohet te të gjithë tregtarët e licencuar nga ERE dhe të regjistruar në tregun e energjisë elektrike,

brenda afateve të parashikuara dhe në përputhje me Rregullat e Tregut;

10. “Regjistri i tregtarëve të energjisë elektrike” do të konsiderohet regjistri që mbahet nga shitësi për të gjithë subjektet tregtuese të energjisë elektrike, i cili përfshin kontaktet e personave përgjegjës, për të siguruar të dhënat e nevojshme dhe informacionin për procesin e shitjes së tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike;

11. “Terma komerciale” janë tërësia e atyre elementeve, të cilët kanë të bëjnë me kushtet teknike, sasinë, çmimet e shitjes së tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, lëvrimin, kapacitetet e interkonjeksionit, si dhe tarifat ose pagesat e tjera që shoqërojnë transaksionin e shitjes;

12. “Kapacitetet e transmetimit/interkonjeksionit” janë kapacitetet e interkonjeksionit, të cilat sigurohen nga shitësi dhe/ose tregtarët, për të mundësuar shitjen e tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike;

13. “Platformë IT *online*” do të konsiderohet platforma elektronike e publikimit të të dhënave të shitësit, në funksion të shitjes së tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike.

Neni 5 Përgjegjësitë

Shitësi është përgjegjës për përcaktimin e grafikut të fuqisë në mw (megawat) dhe atë të energjisë elektrike në mwh (megawat/orë), përkatësisht (në kapacitetin dhe në sasinë e energjisë elektrike), si dhe për përcaktimin e periudhës kohore dhe programit të livrimit të tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, e cila llogaritet në përputhje me ligjin e sektorit të energjisë elektrike, rregullave të tregut të energjisë elektrike, si dhe të kodeve të funksionimit të rrjetit.

Neni 6 Formati i mbledhjes, paraqitjes dhe shqyrtimit të ofertave

1. Për të gjitha ndërveprimet me tregtarët e energjisë elektrike, në procesin e shitjes së tepricave, të prodhuara nga prodhuesit me



përparësi të energjisë elektrike, shitësi përdor platformën IT *online*. Platforma IT është në çdo rast e disponueshme *online*.

2. Shitësi administron kalendarin e ofertave dhe regjistrin e tregtarëve të energjisë elektrike. Të gjitha ofertat, koha e paraqitjes dhe çdo detaj i ofertës ruhen në sistem për një afat 5-vjeçar.

3. Paraqitja e ofertave nga tregtarët e energjisë elektrike, bëhet *online* në platformën IT, sipas përcaktimit në pikën 1 të këtij neni, dhe sipas njoftimit për ditën e paraqitjes së ofertave. Koha e hapjes dhe e mbylljes së procedurës është e publikuar në kalendarin e ofertave.

4. Shqyrtimi i plotësimit të ofertave dhe vlerësimi i tyre, bëhet në mënyrë automatike përmes sistemit *online*. Rezultatet e procedurave të tenderimit, të cilat përmbajnë të dhëna për tregtarët e energjisë elektrike që kanë paraqitur ofertat, si dhe të gjithë informacionin e depozituar të ofertave së bashku me ofertat e përzgjedhura paraqiten në mënyrë automatike në ERE.

5. Shitësi, nëpërmjet sistemit/platformës *online* të IT-së, duhet të publikojë rezultatet/çmimet për njësi të shitjes së energjisë elektrike në mënyrë anonime dhe të grumbulluar, me çmime mesatare, si dhe sasitë e shitura për procedurat që realizon.

Neni 7

Formati i ofertave

1. Të gjitha ofertat e paraqitura në platformën *online*, të shitjes së tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, për çdo proces shitje, duhet të përmbajnë informacionin e mëposhtëm:

- i. emrin e ofertuesit;
- ii. kapacitetin e ofruar/periudhën në (mw);
- iii. çmimin/njësine/periudhën (euro/mwh).

2. Të gjitha ofertat duhet të jenë të pandryshueshme dhe të paraqiten për të gjithë periudhën, për të cilën është kërkuar të shitet energjia elektrike nga shitësi. Kapaciteti i ofertave duhet të jetë midis 1 mw dhe kapacitetit total të siguruar për periudhën respektive.

3. Çdo proces shitje, i tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, ka një periudhë fikse për livrimin dhe një kapacitet fiks të përcaktuar, për të gjithë periudhën që rezulton nga një sasi maksimale që mbulohet prej

procesit të shitjes së energjisë elektrike. Kur mënyra e vlerësuar e shitjes së tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, parashikon kërkesa të ndryshme gjatë kësaj periudhe, organizohen procedura të veçanta me periudha fikse livrimi dhe kapacitete fikse. Kjo nuk duhet të dëmtojë mundësinë e tregtarëve të energjisë elektrike për të paraqitur oferta, të cilat janë më pak se kapaciteti maksimal që është siguruar.

Neni 8

Kontratat për shitjen e tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike

1. Shitja e tepricave të energjisë elektrike, të prodhuara nga prodhuesit me përparësi nga shitësi, sipas parashikimit në nenin 2 (1) të rregullores, kryhet mbi bazën e kontratave, të cilat lidhen si rrjedhojë e procedurave dhe kritereve të përcaktuara në këtë rregullore.

2. Kontratat për shitjen e tepricave, të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, hartohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për sektorin e energjisë elektrike, si dhe Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë.

Neni 9

Publikimi i informacionit për procedurat e shitjes së tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike

1. Për secilën procedurë shitje të tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, i gjithë informacioni i specifikuar në paragrafin 2 më poshtë, publikohet në kalendarin e ofertave dhe u vihet në dispozicion pjesëmarrësve të tregut nga platforma IT *online* e shitësit.

2. Informacioni për çdo shitje të energjisë elektrike publikohet përmes platformës IT *online* dhe duhet të përmbajë minimalisht të dhëna për:

i. sasinë e përgjithshme të energjisë elektrike në mwh, që kërkohet për t'u shitur në çdo proces shitje të tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike;

ii. kapacitetin maksimal të energjisë elektrike në mw, që mund të ofrohet për çdo proces shitje të tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike;



iii. periudhën e plotë kohore të livrimit të energjisë elektrike, të përcaktuar në marrëdhëniet kontraktuale të shitjes ndërmjet shitësit dhe tregtarit që blen energjinë elektrike nga shitësi;

iv. siguruesin e kapaciteteve të transmetimit;

v. kërkesat për kualifikimin në procedurën e shitjes së tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, siç parashikohet në nenin 10 të kësaj rregulloreje;

vi. kriterin ose vlerësimin e ofertave në përputhje me nenin 11;

vii. kushtet e pagesave.

3. Në faqen zyrtare të shitësit, informacioni i përfshirë në kalendarin e ofertave publikohet në gjuhën shqipe dhe angleze. Në rast pasaktësish dhe/ose mospërputhjesh, merret për bazë teksti i informacionit të dhënë në gjuhën shqipe.

4. Brenda periudhës prej një dite pune, pas përfundimit të procesit të shitjes së tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, në platformën përkatëse të IT, publikohet informacioni i mëposhtëm:

i. emrat e ofertuesve;

ii. kapacitetet e ofruara për çdo ofertë (mw);

iii. sasitë e ofruara për çdo ofertë (mwh);

iv. çmimi /njësia për çdo (euro/mwh);

v. vlera totale për çdo proces shitje të tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike (euro);

vi. profilet e livrimit për çdo ofertë;

vii. pikat e livrimit të tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, për çdo ofertë;

viii. vlefshmëria e të gjitha ofertave;

ix. shpallja e fituesve dhe/ose shoqëritë që nuk janë fituese.

5. Shitësi publikon në faqen zyrtare të internetit një kopje të të gjitha ankesave të paraqitura, si dhe të përgjigjeve për ankesën.

Neni 10

Dokumentacioni ligjor dhe administrativ

1. Çdo tregtar i energjisë elektrike, që dëshiron të marrë pjesë në procedurën e shitjes së tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, duhet t'i paraqesë shitësit dokumentacionin e nevojshëm administrativ, që vërteton aftësitë e tij ligjore dhe financiare për shitjen dhe tregtimin e energjisë elektrike, nga

institucionet kompetente të shteteve përkatëse ku është regjistruar, si më poshtë:

a) dokumentacionin që vërteton regjistrimin e shoqërisë në regjistrat përkatës tregtar/gjyqësor të shtetit në të cilin shoqëria është krijuar apo regjistruar;

b) licencën për tregtimin e energjisë elektrike, të lëshuar nga ERE për tregtarët të cilët janë krijuar apo regjistruar në Republikën e Shqipërisë, apo shtetet përkatëse për ata tregtarë të energjisë elektrike të cilët janë krijuar apo regjistruar jashtë Republikës së Shqipërisë;

c) dokumentacionin e lëshuar nga institucionet kompetente të shtetit përkatës, i cili duhet të vërtetojë, që:

i. tregtari nuk është në proces falimentimi (dokument i lëshuar nga QKB-ja);

ii. tregtari apo përfaqësuesit ligjorë të shoqërisë nuk janë dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për shkelje penale;

iii. tregtari apo përfaqësuesit ligjorë të shoqërisë nuk janë dënuar me vendim gjykate të formës së prerë, për çështje që lidhen me aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike;

d) dokumentet e parashtruara në pikën “c” të këtij neni, do të përtërihen nga të gjithë pjesëmarrësit e regjistruar, brenda muajit dhjetor të çdo viti dhe do të jenë të vlefshëm për vitin pasardhës. Në çdo rast dhe në çdo kohë shitësi mund t'i kërkojë pjesëmarrësve të regjistruar paraqitjen brenda 30 ditëve dhe jo më shumë se 3 herë në vit, të secilit nga dokumentet e parashikuar në pikën “c” të këtij neni, me qëllim verifikimin e statusit ligjor të subjektit. Mos dërgimi i dokumentacionit të kërkuar brenda afatit të përcaktuar sjell për pasojë çregjistrimin e pjesëmarrësit të licencuar nga regjistri i shitësit.

2. Në njoftimin publik, ku tregtarët ftohen për të paraqitur dokumentacionin, këto kërkesa duhet të përmenden në mënyrë të qartë që janë kusht kualifikues.

3. Tregtarët të cilët nuk i përmbushin kërkesat e vendosura në paragrafin 1, konsiderohen të papërshtatshëm për të dhënë ofertë.

4. Tregtarët që shprehin për herë të parë interesin e tyre për të marrë pjesë në procedurat e shitjes së energjisë elektrike, të zhvilluar nga shitësi, por nuk kanë depozituar dokumentacionin ligjor sipas referimit të paragrafit 1 (c) të këtij neni, duhet ta prezantojnë dokumentacionin e mësipërm



përmes platformës *online* së bashku me dokumentet e shprehjes së interesit.

5. Shoqëritë e tjera të interesuara, të cilat janë të regjistruara për të ofertuar me shitësin në ndonjë procedurë shitje, të tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike në të ardhmen, duhet të paraqesin vetëm formatin e ofertës me të dhënat e specifikuar në nenin 7, paragrafin 1, të kësaj rregulloreje.

6. Shitësi nuk duhet të refuzojë shoqëritë, të cilat kanë paraqitur dokumentacionin e plotë, edhe nëse ai është paraqitur me pjesë për të marrë pjesë në procedurat e shitjes së tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike.

Neni 11

Kriteret për vlerësimin e ofertave në procedurat e shitjes së tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike

1. Platforma e IT-së *online* për shitjen e tepricave, të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, nga Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a., i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik të përcaktuar në nenin 2 të kësaj rregulloreje, vlerëson në mënyrë automatike ofertat e ardhura, kohën e hapjes/mbylljes bazuar vetëm në çmimin për mwh të ofruar. Platforma e IT-së duhet të zgjedhë të gjitha ofertat për të maksimizuar fitimin e shoqërisë së ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a., për çdo proces shitjeje të tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike.

2. Fitues janë ato oferta të cilat grumbullohen sipas rezultatit me çmim për mwh më të lartë të paraqitur. Në rastin kur ofertat kanë të njëjtën sasi dhe çmim duhet të aplikohet parimi “kush vjen i pari - shërbehet i pari” (*first-come-first serve*).

Neni 12

Komunikimi i Autoritetit Kontraktor me pjesëmarrësit në procedurat për shitjen e tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike

1. Çdo komunikim i shitësit me shoqëritë pjesëmarrëse, në lidhje me procedurat e shitjes së energjisë elektrike, do të bëhet vetëm përmes

platformës IT *online*, për shitjen e tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, pas regjistrimit të tregtarëve të energjisë elektrike.

2. Të gjithë njoftimet që bëhen shkak ose arsye që të ndryshojnë kalendarin e ofertave bëhen me shkrim dhe publikohen në faqen e internetit të shitësit. Ndalohet çdo formë tjetër komunikimi ose negociimi midis shitësit dhe tregtarëve të energjisë elektrike ose midis tregtarëve të energjisë elektrike me njëri-tjetrin.

Neni 13

Procedura e shitjes së tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike

1. Shitësi zhvillon strategjinë/metodologjinë për mënyrën e realizimit të shitjes së tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, për të gjithë tepricën e energjisë elektrike që parashikon të shesë sipas rastit, përgjatë gjithë vitit kalendarik. Ai duhet të përditësojë strategjinë/metodologjinë për mënyrën e realizimit të shitjes së tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike.

2. Të gjitha ndryshimet në strategjinë/metodologjinë për mënyrën e shitjes së tepricave, të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, të cilat ndikojnë në mënyrë direkte në sasinë dhe frekuencën e shitjes, që çon në një ndryshim në procesin e shitjes, duhet të përfshihet në kalendarin e ofertave brenda një dite.

3. Strategjia/metodologjia për mënyrën e shitjes së tepricave, të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, ka si qëllim maksimizimin e fitimit për shoqërinë e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a., përgjatë gjithë vitit kalendarik.

4. Strategjia/metodologjia për mënyrën e shitjes së tepricave, të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, dhe paraqitja e saj në kalendarin e ofertave, duhet të përmbajë:

- i. sasinë e tepërt të energjisë elektrike në mwh që do të shitet;
- ii. periudhën dhe ditën e shitjes;
- iii. grafikun ditor të livrimit të energjisë elektrike;
- iv. kohëzgjatjen e livrimit të energjisë elektrike;
- v. datën/orën e paraqitjes së ofertave.



5. Çdo paraqitje e ofertës, për shitjen e tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, nga çdo ofertues kryhet përmes platformës përkatëse *online* për shitjen e energjisë elektrike.

6. Vlerësimi i ofertave zhvillohet në mënyrë automatike, në përputhje me nenin 11 të kësaj rregulloreje. Rregullat dhe kriteret për vlerësimin publikohen në faqen zyrtare të Autoritetit Kontraktor dhe në platformën e IT-së.

7. I gjithë informacioni bashkëlidhur procedurës së shitjes së tepricave, të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, së bashku me kontratën e nënshkruar ndërmjet shitësit dhe ofertuesit fitues, dokumentohet dhe ruhet sipas rregullave dhe dispozitave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Ky dokumentacion paraqitet në ERE sipas parashikimeve të kësaj rregulloreje.

Neni 14

Përsëritja e procesit të ofertimit

1. Procesi do të përsëritet, në çdo rast, kur kanë paraqitur ofertat për blerjen e tepricave të energjisë elektrike, të prodhuara nga prodhuesit me përparësi, më pak se tre tregtarë.

2. Oferta skualifikohet, në çdo rast, kur rishikimi, vlerësimi dhe krahasimi nga shitësi nuk është i mundur për shkak të formatit të informacionit të ofertës dhe/ose kur informacioni kërkon sqarim nga ofertuesi. Nëse numri i ofertave pas skualifikimeve të mundshme është më poshtë se tre, procesi do të përsëritet.

3. Përsëritja e procesit të ofertimit njoftohet për të gjithë tregtarët e energjisë elektrike dhe publikohet në platformën *online*, si dhe në faqen zyrtare të shitësit. Përsëritja e procesit bëhet pas publikimit të njoftimit të dështimit të procesit dhe do të kryhet jo më vonë se të nesërmen e asaj dite.

Neni 15

Deklarata e konfliktit të interesave

Para se të fillojë funksionimi i platformës së IT-së, çdo punonjës i shitësit që i është ngarkuar me vendosjen në funksion dhe ecurinë e platformës së IT-së, nënshkruan deklaratën, sipas së cilës ai/ajo duhet të shprehë mungesën e konfliktit të interesit me ofertuesit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 16

Njoftimi i fituesit dhe nënshkrimi i kontratës

1. Njoftimi i fituesit i jepet ofertuesit/ve, që ka/kanë paraqitur ofertat fituese, në përfundim të procesit të vlerësimit të ofertave. Njoftimi i fituesit përmban:

- i. emrin, adresën e ofertuesit;
- ii. periudhën e furnizimit të tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike;
- iii. profilin e furnizimit të tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike;
- iv. sasinë e tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, çmimin/njësi dhe vlerën e kontratës.

2. Pas shpalljes së fituesit, shitësi dhe ofertuesi i shpallur fitues nënshkruajnë kontratën.

Neni 17

Procedura administrative e ankimit

1. Çdo ofertues mund të kërkojë rishikimin e procedurës administrative, e cila ndiqet për shitje të tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, kur gjykon se një vendim i shitësit është në kundërshtim me këtë rregullore, duke ndjekur hapat e mëposhtëm:

a) brenda një afati prej 12 orësh nga momenti i njoftimit të ofertuesit të skualifikuar, ofertuesi paraqet një ankesë me shkrim përmes platformës *online* ose me *e-mail* te shitësi duke u ankuar për shkeljen;

b) në këtë ankesë, ofertuesi duhet të paraqesë emrin dhe adresën, referimin për procedurën konkrete ku ka marrë pjesë, bazën ligjore dhe përshkrimin e shkeljes së pretenduar;

c) kur merr një ankesë, shitësi është i detyruar të miratojë vendimin për pranimin ose jo të ankesës brenda një afati prej 24 orësh nga marrja e ankesës;

d) kur ankuesi nuk është dakord me trajtimin e ankesës nga shitësi atëherë ai i drejtohet ERE-s për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, brenda një afati prej 5 ditëve pune, në përputhje me nenin 24, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar;

e) kur ankuesi nuk është dakord me trajtimin e ankesës nga ERE, ai mund të kundërshtojë



vendimin e ERE-s në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Neni 18

Monitorimi i shitjes së tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike

1. Të gjitha veprimet e shitjes së tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, do të dokumentohen me saktësi. Asnjë shitje e tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, nuk do të kryhet pa dokumentacionin shoqërues të kërkuar nga ligji dhe nga këto rregulla.

2. Deri në datën 5 të çdo muaji shitësi paraqet në ERE një kopje të raportit përmbljedhës përfundimtar për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave dhe një kopje të të gjitha ankesave të paraqitura, nëse ka, si dhe përgjigjet për ankesat për muajin paraardhës.

3. Shitësi është i detyruar të paraqes në mënyrë transparente në ERE të gjithë dokumentacionin për shitjen e energjisë elektrike, brenda autoritetit të ERE-s për monitorim.

4. ERE shqyrton të dhënat e paraqitura nga shitësi dhe vlerëson nëse procesi i ofertës në muajin pararendës përputhet me kriteret dhe dispozitat e kësaj rregulloreje.

5. Në rast se ERE shikon parregullsi në raportet e paraqitura sipas pikës 2 të këtij neni, të cilat mund t'i ngarkohen shitësit dhe/ose ofertuesve, ERE mund të caktojë masë administrative mbështetur në nenin 20, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

Neni 19

Pagesat dhe faturimi

1. I gjithë procesi i rakordimit të sasive të tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike të livruar mes palëve, vlerave përkatëse financiare, si dhe faturimi, duhet të mbyllet brenda 10 ditëve kalendarike nga data e fundit e livrimit të energjisë elektrike. Afatet e pagesës që shitësi do të aplikojë për tregtarët e energjisë elektrike, në procedurat për shitjen e tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi

të energjisë elektrike, do të përcaktohen në ftesën për ofertë.

2. Afati i pagesës, i vendosur në ftesën për ofertë, duhet të jetë i njëjtë për të gjitha shoqëritë tregtare të ftuara në procedurën e shitjes së tepricave të prodhuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, e cila do të realizohet nga i ngarkuari me detyrimin e shërbimit publik, Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a.

3. Kushtet, termat dhe afatet e parashikuara në ftesën për pjesëmarrje të të ngarkuarit me detyrimin e shërbimit publik/Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a., duhet të jenë të njëjta me kontratën e nënshkruar me shoqërinë fituese.

Neni 20

Rishikimi

Këto rregulla janë objekt rishikimi, me vendimin e Bordit të ERE-s, sipas rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”.

Neni 21

Sanksione

Për shkeljen e këtyre rregullave, kur nuk përbën vepër penale, ERE vepron në përputhje me nenin 107, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

Neni 22

Hyrja në fuqi dhe vlefshmëria

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr. 4 (64-2020-2085), datë 2.11.2020, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar për shtetasen Florie Bani, e lindur më datë 16.8.1970, në Delisufaj dhe banuese në Dushk Lushnjë, si dhe caktimin si kujdestar dhe përfaqësues ligjor të saj, shtetasen Hasime Papadopoulos.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 208 lekë